

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 12 (324) Dhjetor 2015 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: WWW.VETERANIJOBVL.ORG

KRYEBASHKIAKU I TIRANËS NGRE FLAMURIN KOMBËTAR NË SHESHIN "SKËNDËRBEJ"

## Veliaj: Të harrojmë ndasitë, bashkë bëjmë gjëra të bukura



FAQE 2

KREU I OBVL THOTË SE KURORËN PËR FESTAT E 28-29 NËNTORIT E VË ATJE KU E VENDOS PRESIDENTI

## Parllaku: Askush nuk mund të dalë mbi Skënderbeun



FAQE 4

KOMANDANT I BRIGADËS U CAKTUA NEXHIP VINÇANI DHE KOMISAR PËLLUMB DSHNICA, DY NGA KUADROT MË ME PËRVOJË

## Rruga luftarake e Brigadës së IV-t Sulmuese



FAQE 5

Nga Sotir BUDINA

Presidenti Nishani shprehet për domosdoshmërinë e konsolidimit të institucioneve

## Ridimensionimi i vlerave të lirisë

Nga Halil RAMA

# Nderim për apostujt e lirisë



**Përmes procesit të dekriminalizimit që duhet ta aplikojmë sa më shpejt të jetë e mundur, t'i japim fund, strehimit në politikë të individëve me rekorde kriminale. Të bëjmë çmos t'i japim debatit politik sensin e shndërrimit në diskutim frytdhënës me rregulla dhe etikë qytetare, kulturë demokratike, pluraliste. Të përshpejtojmë sa të mundemi afrimin me Evropën**

FAQE 3

### NDERIMI

100-VJETORI I LINDJES: VETERANËT E LANÇ TË KOSOVËS DHE OBVL I PROPOZOJNË PRESIDENTIT NISHANI:

## Fadil Hoxha të dekorohet "Nderi i Kombit"



Mimoza Kusari - Lila, ndër të tjera shprehet se e mbështet fuqishëm këtë propozim, për faktin se "Fadil Hoxha, me kontributin dhe angazhimin e tij patriotik ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe pas çlirimit, ku si një burrë shtetas ka vendosur themelet e para të shtetësisë së Kosovës"

FAQE 6

### BOTIME

## Dr. Islam Cani, kërkimtari i palodhur i rrënjës së Kastriotëve



FAQE 7

### HOMAZH

HOMAZH PËR VETERANIN E SHQAR TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE

## IDRIZ METI, QYTETAR NDERI I BASHKIVË PUKË DHE LEZHË

Nga Xhemal MEÇI

FAQE 9

### DOSSIER

## ADEM META, NJERIU PËR TË CILIN MË MERR MALLI

Nga SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 10

### PROFIL

## Vili Mazreku, nipi i Luigj Gurakuqit, mjeku që i dha Elbasanit zemrën e tij në dorë

Nga Gëzim LOKA

FAQE 11



**FESTA**

*Përkujtohet 71-vjetori i Çlirimit të Tiranës: Shqipëria në kah të forcave progresive*

# Veliaj: Tirana është në drejtimin e duhur

*"Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, por edhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, kanë kryer homazhe pranë "Ushtarit të panjohur" dhe kanë theksuar se, bota sot po përballet nga një tjetër terror, i cili pak ditë më parë goditi zemrën e Francës, Parisin.*

**7**1-vjetori i çlirimit të Tiranës është përkujtuar me një ceremoni përkujtimore të organizuar nga kryebashkiaku i kryeqytetit, Erion Veliaj.

Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, kryebashkiaku Erion Veliaj, veteranë, deputetë, qytetarë, etj, më 17 Nëntor zhvilluan homazhe dhe vendosën kurora pranë Monumentit, simbol i luftës çlirimtare të popullit shqiptar. Ishte i pranishëm edhe kryetari i OBVL, general-lejtënant Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, ndërsa kurorën me lule në emër të OBVL, pranë memorialit të Partizanit e vendosën nënkryetari i OBVL, Myfit Guxholi dhe anëtarë të kryesisë, Sotir Budina.

Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, por edhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, kanë kryer homazhe pranë "Ushtarit të panjohur" dhe kanë theksuar se, bota sot po përballet nga një tjetër terror, i cili pak ditë më parë goditi zemrën e Francës, Parisin. "Me ngjarjet e Parisit na kujtohet sërish që duhet të bëjmë zgjedhje çdo ditë, se cilin qytetërim duhet të mbështesim dhe kujt do t'i përkasim.

Më vjen mirë që Tirana, ashtu si 71



vite më parë, është në anën e duhur të historisë. Sot ajo është në anën e Parisit, ashtu sikurse dhe dje ishte në anën e një civilizimi që nuk duronte shtypjen dhe barbarinë. Sot lufta nuk ndodhë nëpër male apo zona të largëta, por në zemrat e shteteve dhe goditet civilizimi në ato qytete që lulëzojnë më shumë. Besoj se edhe Tirana, si çdo qytet tjetër është i prekshëm, megjithatë më vjen mirë që zgjohemi në një qytet të lirë, që kujtojmë nga kemi ardhur për t'u siguruar që nuk përsërisim gabime në të ardhmen dhe



për t'u siguruar se brezi i ri informohet se kombi ynë ka një destinacion dhe ky është Perëndimi e bota e civilizuar, së cilës i përkasim", tha Erion Veliaj.

Kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, duke i uruar gjithë qytetarët e Tiranës për ditën e Çlirimit, sidomos familjet e dëshmorëve, tha se kjo është koha e duhur që ne të zgjedhim se me kë jemi, duke bërë zgjedhjen e duhur në lidhje me qytetërimin që duam të jemi. "Tirana është në anën e duhur, në anën e Parisit", tha kryebashkiaku. "Shqipëria ka pasur njerëz që kanë luftuar për Tiranën dhe ne kemi ditur gjithmonë të bëjmë zgjedhjen e duhur. Më vjen mirë, që zgjedhëm qytetërimin e duhur. Kombi ynë ka një destin dhe ky destin është civilizimi, pra qytetërimi", shtoi Veliaj.

Më pas, ai informoi për aktivitetet e shumta që bashkia e Tiranës ka organizuar në kuadër të 17 Nëntorit.

Kryeparlamentari Meta tha se, Shqipëria është rreshtuar sot në krah të atyre vendeve që luftojnë terrorizmin. "Mesazhi aktual i çlirimit të kryeqytetit dhe Shqipërisë ndaj bishës nazifashiste përkon sot me një mesazh të rëndësishëm, me kontributin që forcat tona të sigurisë japin në luftën kundër terrorizmit, që përbën të keqen më të madhe, me të cilën ballafaqohet sot

Shqipëria, NATO, Europa. Me këtë betejë, vendi i Shqipërisë është gjithnjë në krah të forcave më përpunimtare, progresive dhe kontributi i Shqipërisë nuk do të mungojë asnjëherë", tha Meta.

Pas kryerjes së homazheve, historianë, por edhe veteranë të luftës kanë sjellë dëshmi të rëndësishme historike. Ish-Presidenti Alfred Moisiu tha se është shumë e rëndësishme, që politikanët dhe historianët t'i qëndrojnë linjës së historisë.

**ÇLIRIMI I TIRANËS**

Mëngjesin e 17 nëntorit të vitit 1944, pas 19 ditë e net lufte të ashpër e të pandërprerë, kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana, u çlirua nga trupat gjermane. Operacioni mësymës për çlirimin e Tiranës u përgatit dhe u zhvillua në kuadrin e mësymjes së përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Ai ishte vijimi dhe kulmi i mësymjes së përgjithshme. Çlirimi i kryeqytetit pati rëndësi të madhe politike e ushtarake, pasi kurorëzoi fitoren e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ajo shënoi operacionin më të madh të shkallës operativ-strategjike i zhvilluar nga Ushtria shqiptare në çlirimin e qyteteve.



## Kryebashkiaku Veliaj ngre flamurin kombëtar në sheshin "Skëndërbej"

103 vite Pavarësi, Veliaj: Të harrojmë ndasitë, bashkë bëjmë gjëra të bukura

Ngritja e flamurit 103 vite më parë në Vlorë, u përkujtua simbolikisht në Tiranë, në qëndër të qytetit. Më pas mijëra tullumbace kuq e zi u ngritën në lartësi duke sjell atmosferë festive për qytetarët. Në këtë ditë të rëndësishme historike,



kryetari i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj përcolli mesazhe për bashkim, për të harruar mlllefet dhe ndasitë politike. "Jam shumë krenar që jemi sot bashkë sepse 28 Nëntori është mesazhi i bashkimit. Kur ne shqiptarët bëhemi bashkë, bëjmë gjëra të mrekullueshme, gjëra që veç e veç janë absolutisht të pamundura. Ndaj sot, le t'i harrojmë të gjitha ndasitë, të harrojmë mlllefet, kundërshtitë dhe debatet me njëri-tjetrin", u shpreh kryebashkiaku Erion Veliaj. Edhe pse një ditë me shi, të vegjlit i gëzuan më tepër "spektaklit me tullumbace".

Të pranishëm në ceremoni ishin përfaqësues të komuniteteve fetare, këshilltarë të bashkisë dhe qytetarë, veteran të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, etj..

Për festën e Pavarësisë, kryebashkiaku Erion Veliaj, ngriti flamurin kombëtar pranë sheshit Skëndërbej. Në praninë e mijëra qytetarëve të Tiranës, i shoqëruar dhe nga kryetari i Këshillit të Qarkut, Aldrin Dalipi - njëherazi dhe kryetar i këshillit bashkiak të kryeqytetit, kryebashkiaku Veliaj i uroj ata për 28 Nëntorin. "Ju uroj 28 nëntorin, të na rrojë Shqipëria. Jemi shumë krenarë se shqiptarët kur bëhemi bashkë bëjmë gjëra të bukura," tha kryebashkiaku. Gjithashtu Veliaj shtoi se ishte koha të harronim të gjitha ndasitë dhe mlllefet, dhe bëri thirrje që të ishim gjithnjë të bashkuar për të bërë gjëra të mira për vendin.

"Ju uroj mirëseardhjen të gjithë atyre që kanë ardhur nga Kosova, Maqedonia, e nga treva ku kudo jetojnë shqiptarë dhe që kanë zgjedhur Tiranën për të festuar".

I gjithë sheshi Skëndërbej ishte i mbushur me tullumbace Kuq e Zi.





## FJALA

Presidenti Bujar Nishani shprehet për domosdoshmërinë e konsolidimit të institucioneve



Presidenti i Republikës, Bujar Nishani organizoi më 28 Nëntor 2015 në darkë në Pallatin e Brigadave, pritjen zyrtare me rastin e Festës Kombëtare, Ditës së Pavarësisë dhe të Flamurit. Në këtë pritje merrin pjesë autoritete të shtetit shqiptar, Trupit Diplomatik të akredituar në Shqipëri, deputetë dhe personalitete të artit e kulturës. Të ftuar nga Presidenti i Republikës ishin dhe drejtuesit e OBVL, kryetari Rrahman Parllaku dhe anëtarët e kryesisë: Astrit Leka, Sotir Budina, Fluturak Vinçani, Jorgji Terca, Dhimitër Ndrenika, etj.

Me këtë rast, kreu i shtetit shqiptar mbajti një fjalim të rëndësishëm, të cilin, po e botojmë të plotë më poshtë:

"Burrat e shquar e të nderuar trima e të ditur të së kaluarës, punën dhe sakrificat e të cilëve për shpalljen e Pavarësisë që gëzojmë sot i kemi kujtuar e do t'i kujtojmë gjithmonë me shumë respekt, në kohën e vet e kryen detyrën e tyre më së miri.

Tani fjalën e kemi në shqiptarët e një kohe tjetër, e të tjerave rrethana, të tjerave kushte, të tjerave sfida.

Për shkak të tipareve të kohës së sotme dhe rrethanave specifike të momentit, Shqipëria dhe ne shqiptarët sot ndodhemi në një fazë delikate të historisë sonë moderne.

Në atë moment kur nga mënyra si do t'u bëjmë ballë sfidave që na duhet të përballim do përcaktojmë koordinatat e së ardhmes tonë, fatet tona të ardhme. Çfarë na duhet në këto kushte të bëjmë, janë punë vërtet të mëdha e të vështira, por jo të pamundura.

Që të funksionojnë sa më mirë dhe të jetojnë sa më gjatë, para së gjithash duhet të konsolidojmë institucionet. Të mos lejojmë të na kalçifikohen, të na ngathtësohen institucionet që me sakrificat të panumërta i ngritëm gjatë periudhës tranzicionale. Duke respektuar pavarësinë e secilit institucion ndaj të tjerëve dhe duke aplikuar ndarjen e kompetencave brenda tyre, ësh-të e vetmja mënyrë për të siguruar funksionimin harmonik të Shtetit.

#### TË "DREJTOJMË" DREJTËSINË.

Të marrë fund një herë e përgjithmonë koha kur padrejtësitë më të mëdha i bëjnë ata që pretendojnë se japin Drejtësi.

T'i japim fund, strehimit në politikë të individëve me rekorde kriminale

Përmes procesit të dekriminalizimit që duhet ta aplikojmë sa më shpejt të

# Nderim për apostujt e lirisë

"Përmes procesit të dekriminalizimit që duhet ta aplikojmë sa më shpejt të jetë e mundur, t'i japim fund, strehimit në politikë të individëve me rekorde kriminale. Të bëjmë çmos t'i japim debatit politik sensin e shndërrimit në diskutim frytdhënës me rregulla dhe etikë qytetare, kulturë demokratike, pluraliste. Të përshpejtojmë sa të mundemi afrimin me Evropën



jetë e mundur, t'i japim fund, strehimit në politikë të individëve me rekorde kriminale. Të bëjmë çmos t'i japim debatit politik sensin e shndërrimit në diskutim frytdhënës me rregulla dhe etikë qytetare, kulturë demokratike, pluraliste. Të përshpejtojmë sa të mundemi afrimin me Evropën.

T'i bëjmë këto dhe të tjera, jo me panik, jo me ngut, por në kohën e duhur me mënyrat dhe mjetet e duhura.

Është e vërtetë se edhe pas përpjekjeve të vazhdueshme për humanizimin e teknologjisë, pra marrjes së masave që të mos e skllavërojnë teknologjia njeriun por njeriu ta ketë gjithmonë në kontroll teknologjinë, përsëri teknologjia e ka bërë botën aq

të vogël, sa tashmë nuk ka "afër" e "larg", si në kohë dhe hapësirë gjithçka është bërë e afërt. Nga ky këndvështrim në kohën e sotme nuk ka rrezik, panik, frikë, luftë, apo çfarëdolloj problematike tjetër lokale, por vetëm globale. Sot gjithçka e mirë i gëzon të gjithë, gjithçka e keqe i rrezikon të gjithë. Brenda këtij konteksti globalizimi që duhet ta kemi mirë parasysh, duhet të vlerësojmë, interpretojmë, reagojmë, edhe ne shqiptarët.

Pavarësinë që po festojmë sigurisht që e meritojmë. Por nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se diçka që meritohet edhe shpërdorohet, diçka që fitohet edhe humbet. Që të mos shpërdorojmë e të mos humbim, duhet të

punojmë.

Përndryshe rrezikojmë që kujtimet e mira mbi të parët tanë falë të cilëve gëzojmë Pavarësinë, mund të na shndërrohen në Histori, dhe pak nga pak Historia në Arkeologji, çka nuk duhet kurrsesi të ndodhë.

Të mos e çojmë pra Historinë në muzeum, por ta mbajmë të gjallë, pse jo duke i kthyer hera-herës sytë pas.

#### NDERIM PËR HERONJTË, DISIDENTËT, MARTIRËT E LIRISË

Njëqind e tre vjetori i Pavarësisë e gjen Shqipërinë pranë një date tjetër tejet të rëndësishme për historinë tonë kombëtare. E kam fjalën për 25-vjetorin e rrëzimit të diktaturës nga demonstratat e studentëve në vitin 1990. Janë njëzet e pese vite të plotësimit të një mungese të madhe për ne. Janë 25 vite lirie gjatë të cilave jemi ringritur, jemi përballur me sfida, kemi pasur rezultate, kemi bërë hapa të rëndësishëm në integrimin e vendit, si anëtarësimi në NATO, lëvizja e lirë pa viza e qytetarëve, marrjen e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian si edhe progres të brendshëm në disa fusha.

Gjithashtu edhe kemi humbur beteja, kemi humbur edhe shanse. Gjatë këtyre viteve i kemi mbetur borxh dekomunistizimit të vendit, nderimit për heronjtë, disidentët, martirët, të përndjekurit dhe viktimat e sistemit totalitar që u mund nga liria, si vullnet i këtij populli dhe u la pas për të mos e harruar e për të mos e përsëritur.

Në këtë natë të amzës dhe thagmës kombëtare ju ftoj të gjithëve të nderoni kujtimin e grave dhe burrave që iu kundërvunë diktaturës, të nderoni kujtimin e studentëve të Dhjetorit që me kurajën e tyre i hapën rrugën pluralizmit politik në Shqipëri.

Ka disa vlera që janë te përjetshme. Nderimi për apostujt e lirisë është njëra prej tyre dhe hyn tek e përjetshmja ashtu si edhe dënimi për tiranët dhe tiraninë dhe për të gjithë racën e vrasësve të lirisë.

#### I FTOJ BASHKËQYTETARET E MI TË MOS E BRAKTISIN SHQIPËRINË

Bashkatdhetarët e mi të shtrenjtë, Lejomëni që me përlulësi t'ju kujtoj diçka!

Dikur mbi këtë truall kishte shqiptarë, por nuk kishte shtet. Nëse do punojmë keq, pa krenari patriotike, pa përgjegjshmëri politike, pa ndjeshmëri njerëzore dhe qytetare, nuk është çudi që pas ca kohësh mund të kemi shtetin, por mbi truallin tonë të kenë mbetur më pak shqiptarë.

Të bëjmë çmos që kjo të mos ndodhë. Unë i ftoj bashkëqytetarët e mi të mos e braktisin Shqipërinë sepse me përpjekjet e të gjithëve mund ta shndërrojmë në vendin që duam.

Vëllezër e Motra,  
Sonte është një nate feste dhe optimizmi.

Ju uroj të gjithëve nga zemra: Gëzuar ditëlindjen e shtetit shqiptar kësaj shtëpie të patjetërsueshme që gjithmonë e mban derën hapur për ne, por që gjithmonë ka nevojë për dashurinë, përkushtimin dhe vëmendjen tonë.

Rroftë Shqipëria!  
Zoti i bekoftë shqiptarët kudo ndodhen!

Ju faleminderit!"

## Obama uron Nishanin për Festën e Pavarësisë

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Barack Obama, ka uruar Presidentin e Shqipërisë Bujar Nishani, për Festën e Pavarësisë. Në mesazhin urues të presidentit Obama, shprehen urimet më të mira për popullin shqiptar. Obama thekson përkushtimin e ShBA-së për të ndihmuar Shqipërinë që të përparojë në rrugëtimin e saj drejt integritetit të plotë Euro-Atlantik.

Më poshtë, i plotë urimi i Presidentit Obama:

"I dashur Zoti President,

Ju shpreh urimet më të mira për ju dhe popullin shqiptar edhe në emër të popullit amerikan me rastin e 28 Nëntorit, Ditës suaj të Pavarësisë.

Ky shënon edhe një rast për të reflektuar mbi partneritetin e fortë dhe të qëndrueshëm që gëzojnë Shtetet e Bash-

kuara të Amerikës dhe Shqipëria, ashtu siç u nënvizua edhe nga nënshkrimi në prill i Partneritetit Strategjik Sh. B. A. - Shqipëri. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbeten të përkushtuara për të ndihmuar Shqipërinë që të përparojë në rrugëtimin e saj drejt integritetit të plotë Euro-Atlantik.

U jam mirënjohës kontributeve të Shqipërisë në drejtim të rritjes së paqes dhe qëndrueshmërisë në Ballkan si dhe anëmbanë botës. Ato përfshijnë edhe ndihmesën e vlefshme të Shqipërisë si pjesëtare e Koalicionit Ndërkombëtar që lufton ISIS-in dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm në rajonin e Ballkanit. Unë pres që në këtë drejtim dhe në shumë fusha të tjera të rëndësishme, ta thellojmë bashkëpunimin tonë gjatë viteve në vazhdim.

Edhe njëherë, ju shpreh urimet e mia ndërsa ju kremtoni këtë ditë të gëzuar!



OPINION



**71-vjetori i Çlirimit, krerët e shtetit dhe veteranët e OBVL nderojnë të rënë në Varrezat e Dëshmorëve**

Me rastin e 71-vjetorit të Çlirimit të atdheut, në Varrezat e Dëshmorëve janë mbajtur homazhe në nder të atyre që dhanë jetën për çlirimin e vendit nga okupatorët nazifashistë.

Në ceremoninë shtetërore të organizuar me këtë rast, ishin të pranishëm krerët e shtetit, presidenti Bujar Nishani, kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes, Mimi Kodheli, nënkryetarja e Kuvendit, Valentina Leskaj si dhe funksionarë të ndryshëm dhe deputetë.

Edhe kreu i Bashkisë së Tiranës, Erjon Veliaj vendosi kurora me lule në Varrezat e Dëshmorëve gjatë homazheve të datës 29 nëntor 2015.

Në emër të OBVL, kryetari Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, dhe sekretari organizativ, Sotir Budina vendosën një kurorë me lule pranë monumentit "Nënë Shqipëri".

"Çdo ditë dhe çdo kohë që kalon, çdo përparim që bëhet në rrugën e lirisë, shton nderin për të rënë e kombit, shton nderin për familjet e tyre. Veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ndjehen më krenarë se kurrë në këtë ditë të shënuar pasi shohin të realizuar ëndrën e bashkëlufëtarëve të tyre, të Qemalit, Vasilit, Margaritës e mijëra të tjerëve, për një Shqipëri të lirë e demokratike, shohin të realizuar qëllimin e përbashkët: Kosovën e lirë e të pavarur që përparon drejt shtetit të saj demokratik modern", - u shpreh gjeneral Parllaku pasi bëri homazhe në varrezat e dëshmorëve të kombit.

Pranë varrezave të dëshmorëve kanë zhvilluar homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule edhe krerët lokalë të degëve të OBVL-së, Fluturak Vinçani në Korçë, Genc Ballana në Durrës dhe Ali Demushi në Shkodër.

*Kreu i OBVL thotë se kurorën për festat e 28-29 Nëntorit e vë atje ku e vendos Presidenti*

# Parllaku: Askush nuk mund të dalë mbi Skënderbeun

**" Duke dashur të dalim mbi Skënderbeun dhe Lidhjen e Prizrenit vihet data 29 Nëntor. Ismail Qemali e ngriti Flamurin në 28 Nëntor, sepse e kishte ngritur Skënderbeun në Krujë në këtë datë**

Gjeneral Rrahman Parllaku, protagonist i luftës kundër nazifashizmit, ka bërë një dalim të qartë mes dy datave më të rëndësishme historike të kombit shqiptar; 28 dhe 29 Nëntorit. Parllaku thekson se 29 Nëntori 1944 është Dita e Çlirimit të vendit dhe është një ditë e shënuar vetëm për popullin shqiptar. Ndërkaq, për Parllakun 28 Nëntori ka një rëndësi shumë të madhe, sepse është festa e pavarësisë së të gjithë shqiptarëve, Kosovës, trevave shqiptare dhe e të gjithë shqiptarëve të Diasporës. "28 Nëntori 1912 është festë kombëtare e të gjithë shqiptarëve kudo që janë. Kjo është dita e flamurit shqiptar. Është festë kombëtare për të gjithë shqiptarët në Kosovë, Maqedoni, Preshevë, Mal të Zi dhe e të gjithë shqiptarëve të Diasporës. 29 Nëntori 1944 është Dita e Çlirimit të vendit, është festë e shqiptarëve të Shqipërisë. Unë kam përgatitur dy parada, dhe të gjitha janë bërë në 29 Nëntor", sqaron Parllaku në një prononcim për gazetën "Sot". Rrahman Parllaku thotë se askush nuk mund të dalë mbi Skënderbeun dhe Lidhjen e Prizrenit, ndërsa thekson rëndësinë historike që ka 28 Nëntori si datë. "Duke dashur të dalim mbi Skënderbeun dhe Lidhjen e Prizrenit vihet data 29 Nëntor. Ismail Qemali e ngriti Flamurin në 28 Nëntor, sepse e kishte ngritur Skënderbeun në Krujë në këtë datë. Enveri



udhëhoqi luftën dhe unë jam për atë që të përkujtohet lufta. Unë kurorën, edhe kur janë në pushtet demokratët dhe kur janë socialistët e vë atje ku e vë presidenti, ai është kreu i shtetit", u shpreh Parllaku.

**LUFTA PARTIZANE**

Rrahman Parllaku, gjeneral i që luftoi nazifashizmin dhe

u radhit përkrah intelektualëve kundër komunizmit, sqaron dhe të vërtetën e madhe të luftës partizane të popullit shqiptar. Parllaku thekson se çlirimin e vendit e sollën partizanët dhe gjaku i 28 mijë dëshmorëve të rënë për liri.

Ai thotë se Enveri e udhëhoqi luftën, por luftën nuk e bëri Enveri. "Enveri ishte komandat

i Shtabit të Përgjithshëm pas 10 korrikut 1943, por luftën nuk e ka bërë Enveri. Luftën e kanë bërë 70 mijë partizanët dhe 28 mijë dëshmorët. E kanë bërë shtabet, komandantin e reparteve partizane. Askush nuk mund të thotë se ku ishte dhe kë komandoi Enver Hoxha gjatë Operacionit Armik të Dimrit 1943-1944. Brigadat tona luftuan me vetëdije të drejtuar nga komandat e tyre. Ishin komandantët e brigadave që organizuan dhe drejtuan luftën deri në çlirimin e plotë të atdheut", thotë Parllaku.

Rrahman Parllaku shprehet se pas çlirimit të vendit, Enver Hoxha pushkatoi dhe internoi shumë intelektualë si dhe gjithashtu dënoi 17 komanda të luftës partizane. "Por pas luftës, diktatura e Enver Hoxhës goditi pa mëshirë ata që drejtuan, organizuan dhe fituan këtë luftë legjendare. Nga 24 brigada, 17 komanda i ka dënuar Enver Hoxha me pushkatim, vdekje në burgje, internime. Dhe jo vetëm ata. Por, kanë vuajtur të gjitha familjet dhe fisi i tyre, ngjarje kriminale e makabre këto që nuk kanë ndodhur në asnjë diktaturë të botës", u shpreh Parllaku.

## Petro Koçi: LANÇ vlerë kombëtare, dëshmorët simboli i nacionalizmit

Zv/ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, ka vlerësuar Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare si vlerë kombëtare, ndërsa thekson se dëshmorët e rënë për liri janë simbol i nacionalizmit. "Qeveria e të majtës socialiste dhe progresiste e konsideron LANÇ dhe dëshmorët e saj vlerë kombëtare, tek e cila duhet të bashkohemi të gjithë. Dëshmorët e LANÇ janë simboli më kuptimplotë i nacionalizmit me vepra në raport me nacionalizmin me fjalë, të vetëshpallur që u lidh me pushtuesin fashist e nazist për interesa pushteti dhe tregtie", thekson Koçi. Ai vlerëson punën e veteranëve të luftës, të cilët gjithmonë kanë vënë

në plan të parë interesat e kombit.

"Në prag të festave tona kombëtare të 28 e 29 Nëntorit është koha për të kuptuar se betejat për çlirim janë sfida që nuk rreshtin kurrë. Prandaj, puna e palodhur e organizatës tuaj dhe e veteranëve të LANÇ për të rilindur idealizmin kombëtar, shpirtin e sakrificës për interesin publik merr një vlerë bashkëkohore që i shërben të ardhmes tonë evropiane e jo thjesht arkivave të së shkuarës. Investimi për një shpirt idealist shoqëror është goditje ndaj pragmatizmit të paskrupullt që vë interesin pasuror e politik personal mbi atë strategjik kombëtar", thotë Koçi. Petro Koçi vlerëson se

veteranët nuk luftuan kurrë për privilegje, dhe ne duhet të përulemi përpara veprës së dëshmorëve tanë. "Çdo dëshmorë dhe çdo ish partizan e kreu trimërinë e kohës së vet, duke guxuar dhënien e jetës për atdheun. Por ata nuk e dhanë jetën për privilegje! Trimëria moderne e kohës së sotme për çdo qytetar e zyrtar është kurajo për të qenë të ndershëm. Respekt e përulje ndaj veprës së dëshmorëve të lavdishëm të atdheut tonë! Punë të mbarë e të suksesshme Organizatës misionare për dëshmorët e LANÇ dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut! Gëzuar festat e mëdha kuqezi të 28 e 29 Nëntorit! Rroftë Shqipëria!", u shpreh Koçi.

## LAMTUMIRË ALLAMAN BEKTASH AGA!

Para një muaji u nda nga jeta veterani i fundit nga agallarët e Arbanës së Tiranës, Allaman Bektash Aga. Ai si dhe dhjetra të afërm të tij nga ky fisi i madh i falën rininë e tyre, po ashtu edhe kapitalet e tyre i vinë në dispozicion të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

E pra Allamani ishte i fundit të (muhikaneve). Me këtë rast dëshiroj ti përmend të gjithë kushërinjtë veteranë, (vëllezërit) e të ndjerit Allaman Bektash Aga.

Baba, xhaxhai, burr me pak fjalë, por shumë punëmadh, kuadër e burrë me moralin që e karakterizonte, po ashtu pra i rriti edhe fëmijët e tij. Allahu të faltë

Xhajë.....e inshalla ju bashkon ashtu si në kohët e vështira të luftës. Amin!

Nga xhaja Allaman qe sa të jem gjallë nuk do ta harroj, ruaj urtësinë e tij natyrale e me shumë njohuri mbi të shkuemen e kohës; po ashtu edhe mbi historinë e fiseve tona. Sot unë po shkruaj kto pak rrjeshta në kujtim të veteranit të fundit nga fisi i agallarëve, por me këtë rast do ti përmend të gjithë kushërinjtë, të angazhuar si në çdo luftë për mbrojtjen e vatanit, ashtu edhe në luftën e dytë botërore, e që shumëkush e din mirë kontributin e ktyre djemve që s'u ndanë kurrë duke ruajtur çdo moral e ndjeshmëri për fisin e tyne shumë fisnik e atdhetar, që

edhe pse u dogjën, u vranë, u plagosën, por asnjëherë nuk u përkulën edhe pse disa prej ktyre u ndëshkuan e dënuan, ato unë gjithmonë i kam parë të pa ndarë e gojëmbël.

Po përmend të gjithë agallarët që ishin kushërinj e shumë të afërt fatkeqësisht të gjithë të vdekur. Është edhe njëi, Ramazan Ymer Aga, por edhe ai ndodhet në Itali e është i pafuqishëm; Pra me dëshmi veterani të nxjerrë nga rregjistrat e shkruajtura në kohën e pjesmarrjes vullnetare, pasi më 24 Maj 1944 filloi mobilizimi i përgjithshëm e nuk njihesh veteran. Qazim Aga u vra. Ali Aga Visha, ish edhe futbollist i shpresës, i vetmi që

njihet si Hero i Popullit, e asnji nga këta nuk është përmend. Pra Qazimit ne nuk i dimë as varrin ku e ka. Këta djem, ish luftëtarë, besoj meritajnë pak fjalë për kujtesë. Ja edhe i fundit shkoi të bashkohet me vëllezërit e tij atje. Po me këtë rast po përmend edhe xhajën Riza, i cili u nda jeta dy muaj më parë në moshën 114-vjeçare, i cili fliste me mendjen e tij të kthjellët sikur po i jetonte në atë çast momentet e nisjes së burrave për në mbrojtje të Shkodrës. Falenderim stafit të gazetës "Veterani" për kujtesën e ktyre burrave që janë brezi i sakrificës e mundimit.

Halit AGA



## DOSSIER

Komandant i Brigadës u caktua Nexhip Vinçani dhe komisar Pëllumb Dishnica, dy nga kuadrot më me përvojë

# Rruga luftarake e Brigadës së IV-t Sulmuese



Në fundin e vitit 1943 dhe fillimin e 1944-trës, kur lufta Nacionalçlirimtare kundra okupatorit fashist kishte marrë përparime të mëdha në të gjitha krahinat e vendit, për t'a goditur më me efektivitet armikun, lindi nevoja e krijimit të njësisve të mëdha partizane. Kështu, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, pas krijimit të Brigadës së I-rë S, më 28 Dhjetor 1943, në Voskopojën me tradita patriotike e kulturore, u formua Brigada e IV-t Sulmuese, e cila gjatë luftës dha një kontribut të shquar për çlirimin e vendit. Në këtë brigadë u inkuadruan partizanë dhe kuadro me shumë përvojë luftarake të fituara në luftimet me armikun, të batalioneve "Shqiponja", "Gor-Opar", "Tomori", "Çlirimi", "Fuat Babani", "Hakmarrja", si dhe u dërgua një numër i madh vullnetarësh dhe kuadros nga qyteti i Korçës. Brigada u organizua me katër batalione dhe kishte një efektiv prej 600 partizanë, por shumë shpejt gjatë luftimeve me armikun, ajo u dyfishua me partizanë vullnetarë të krahinave të Shqipërisë së Mesme. Me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, komandant i Brigadës u caktua Nexhip Vinçani dhe komisar Pëllumb Dishnica, dy nga kuadrot më me përvojë luftarake, të sprovuar në luftimet kundra armikut në qarkun e Korçës, patriotë dhe revolucionarë të brumosur me ndjenja patriotike për çlirimin e vendit. Përveç këtyre në Shtabin e Brigadës dhe në komandat e batalioneve u caktuan dhe shumë kuadro të dalluar në aksione dhe luftime të çetave partizane të qarkut të Korçës, si Vaskë Gjino, Petrit Dume, Spiro Shalësi, Pano Xhamballa, Zija Kambo, Gafurr Çuçi, Xhafer Lubonja, Gaço

Peristeri, Vera Pojani, Eleni Pashko, Fatmir Glata, Raqi Qirinxhi, Milo Qirko, Sotir Filto, Halit Mati etj, të cilët me përvojën dhe aftësitë e tyre të fituara në luftimet me armikun, dhanë një kontribut të madh në të gjitha luftimet që bëri kjo brigadë, që nga krijimi e deri në çlirimin e vendit.

Armiku ishte i alarmuar nga krijimi i Brigadës së IV-t S në qarkun e Korçës dhe i tronditur nga aksionet e befasishme dhe të vazhdueshme të çetave dhe batalioneve partizane, të cilat me luftimet e tyre goditëse ishin bërë pengesë e madhe për lëvizjen e forcave gjermane nga Korça për në Greqi dhe në Jugosllavi. Gjermanët, me qëllim për t'i shpartalluar ato, me forcat e divizionit 100 të tyre të dislokuar në qarkun e Korçës (me një efektiv prej 900 kuadro e ushtarë dhe 1000 ballistë) si dhe me shumë forca të tjera armike nga Berati dhe Elbasani, ndërmoren dy operacione të mëdha: atë të Dimrit 1943 dhe atë të Qershorit 1944.

Por me gjithë dëmet e mëdha që shkaktoi armiku me këto operacione, në të gjitha krahinat e qarkut të Korçës, duge djegur dhe masakruar shumë fshatra, nuk ia arriti qëllimit për t'i shpartalluar forcat partizane. Në këtë situatë të vështirë, batalionet territoriale dhe forcat e Brigadës së IV-t S, falë drejtimit të përsosur të komandantit të saj Nexhip Vinçani, heroizmit të partizanëve dhe mbështetjes totale të popullit të krahinës së Korçës, jo vetëm përballuan me sukses mësymjen e armikut dhe i shpëtuan rrethimit në këto dy operacione të mëdha, por e detyruan armikun të tërhiqet, duke pësuar humbje të mëdha në njerëz dhe teknikë luftarake. Pas

*Brigada u organizua me katër batalione dhe kishte një efektiv prej 600 partizanë, por shumë shpejt gjatë luftimeve me armikun, ajo u dyfishua me partizanë vullnetarë të krahinave të Shqipërisë së Mesme*



kësaj disfate që pësuan gjermanët në këto dy operacione, Brigada e IV-t S dhe batalionet territoriale, me goditje dhe luftime të vazhdueshme ndaj armikut, çliroi të gjitha krahinat e pushtuara nga gjermanët në qarkun e Korçës, atë të Goroparit, Kolonjës, Mokrës, Pojanit, Devollit etj.

Pas luftimeve të suksesshme kundra pushtuesve gjermanë në Operacionet e Dimrit dhe Qershorit, Brigada e IV-t S, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇI, në maji 1944 u inkuadrua në Divizionin e I-rë S dhe mori pjesë në operacionin mësymës për çlirimin e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut. Në këtë operacion repartet e Brigadës së IV-t S, me luftime të shumta kundra okupatorit gjerman dhe forcave balliste, çliroi krahinat: Qarishtë, Zerqan, Mat, Fushë Alie dhe në bashkëveprim edhe me çetat territoriale çliroi edhe qytetet e Dibërës dhe të Elbasanit. Në këto luftime të suksesshme për çlirimin e krahinave të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, repartet partizane të Brigadës së IV-t S patën një rritje të vazhdueshme, jo vetëm në përgatitjen luftarake, por në krahinat ku luftonin e dyfishuan efektivin e brigadës me partizanë vullnetarë të rinj, të cilët luftuan me vendosmëri dhe trimëri deri në çlirimin e plotë të vendit.

Pas luftimeve të shumta për çlirimin e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Veriut, Brigada e IV-t S, së bashku me brigadat e I-rë, VIII-të dhe XVII, më 29 Tetor 1944, me urdhër të Shtabit të Korp Armatës së parë që drejtonte operacionin

për çlirimin e Tiranës, mori pjesë në këtë operacion të rëndësishëm, kundër forcave të shumta të përqëndruara gjermane e balliste, për rreth kryeqytetit, me detyrë për të mbrojtur Tiranën dhe për të siguruar tërheqjen e trupave gjermane nga Greqia për në Jugosllavi. Në këtë operacion vendimtar për çlirimin e Tiranës dhe të gjithë vendit tonë, Brigada e I-rë u caktua të sulmonte armikun në veri të kryeqytetit, kurse Brigada e IV-tu caktua të sulmonte në drejtimin kryesor më të fortifikuar të kryeqytetit, në rrugën Elbasan-Tiranë, në sektorin Pallati i ri Mbretëror - Kodra e Kopilit - Kisha e Shën Prokopit, kurse Brigada e VIII-të u caktua të sulmonte në drejtimin: Gazemat e Ali Rizajt, ndërsa Brigada e XVII-të u caktua të luftonte në Qafë Krrabë. Repartet e Brigadës së IV-t S, gjatë 45 ditëve lufte të vazhdueshme me autokolonat gjermane në Qafë Krrabë dhe me forcat gjermane që mbronin kryeqytetin, të mbështetura fuqishëm nga aviacioni anglo-amerikan, i cili çdo ditë bombardonte armikun nga Qafë Krraba në Tiranë, jo vetëm bllokoi lëvizjen e autokolonave armike, por pas luftimeve të rrufeshme trup me trup, në Betejën historike të Mushqetasë, arriti të shpartallojë dhe asgjësojë totalisht forcat gjermane. Në këtë betejë shumë të përgatitur dhe vendimtare për çlirimin e kryeqytetit, që e bëri Brigadën e IV-t S të lavdishme, armiku pati 500 të vrarë, 600 të plagosur dhe 400 robër, midis të cilëve 30 oficerë. Brigada e IV-të Sulmuese, në betejën për çlirimin e Tiranës i dha atdheut 98 dëshmorë. Në të gjitha luftimet, nga krijimi deri në çlirimin e plotë të vendit, Brigada e IV-të Sulmuese, duke qenë një nga njësitë më të suksesshme të Ushtrisë partizane, i plotësoi me nder detyrat e vëna dhe i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmyjet të cilëve nën komandantin e Brigadës Pano Xhamballa, komandantin trim Xhafer Lubonja, partizanin Riza Taçi etj.

Rruga luftarake e Brigadës së IV-t Sulmuese, trimëria dhe heroizmi i luftëtarëve të saj në luftën për çlirimin e vendit, janë sot një burim i madh frymëzimi për gjithë popullin, dhe veçanërisht për rininë, në procesin e ndërtimit të demokracisë së vërtetë dhe mbrojtjen e atdheut.

**Kolonel Sotir Budina**  
Ish-kuadër i Brigadës së IV-t S

## HYSEN ORANLLI, ANTIFASHISTI I ORËVE TË PARA

Para disa ditësh u nda nga jeta antifashisti i orëve të para, Hysen Oranlli. Ai lindi më 1923 në një familje patriotike, që i përkiste një shtrese fshatare të pasur.

Hyseni, që në moshë të vogël, i frymëzuar dhe nga i ati me frymë patriotike, ndjeu shtypjen e regjimit fashist, ndaj dhe mori pushkën e doli në mal me gjithë shokët e tij.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ai është shquar për trimëri e guxim të rrallë. Ishte i dashur me shokët, i disiplinuar dhe për rrjedhojë edhe i respektuar prej

tyre. Hysen Oranlli nuk ju nda luftës deri në çlirimin e plotë të vendit nga okupatori nazifashist.

Për trimërinë në luftë dhe për shërbimin me devotshmëri ndaj atdheut është vlerësuar me disa Medalje, si atë të Çlirimit, Vjetërsisë, Trimërisë etj.

Edhe familja e Hysenit ka dhënë një kontribut të çmuar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ajo ka qenë bazë e LANÇ.

Por me gjithë këto merita, gjatë regjimit komunist ai u trajtua shumë keq, me përndjekje dhe me përçmim. Me ardhjen e demokracisë u bë një

mbështetës i saj. Krijoi një shoqatë të ish pronarëve për të cilën punoi me përkushtim deri në çastet e fundit të jetës. Me të njejtin përkushtim ai militoi edhe në OBVL, dega Korçë. Shtëpia e tij u kthye në zyrë e OBVL, Korçë, në mungesë të ambjenteve të tjera për të. Me vdekjen e tij, familjarët humbën një njeri të çmuar, por edhe në bashkëluftëtarët e bashkëpunëtorët e tij humbën një mik dhe një shok të respektuar.

*I paharruar qoftë kujtimi i tij!*

**Fluturak A. VINÇANI**



**NDERIMI**

100 - vjetori i lindjes

# Veteranët e Kosovës dhe OBVL, propozim për dekorimin e Fadil Hoxhës

**Mimoza Kusari - Lila, ndër të tjera shprehet se e mbështet fuqishëm këtë propozim, për faktin se "Fadil Hoxha, me kontributin dhe angazhimin e tij patriotik ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe pas çlirimit, ku si një burrë shtetas ka vendosur themelet e para të shtetësisë së Kosovës"**

Hoxha, Hero i Popullit në Kosovë, ka qenë një ndër emrat më të njohur të politikës në territoret shqiptare për 50 vite me radhë në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore".

Fadil Hoxha lindi në Gjakovë, u shkollua në Krumë, Shkodër dhe Elbasan ku frymëzoi rininë të bashkohej me luftën e përgjithshme Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ai shërbeu si mësues në fshatrat e Veriut të Shqipërisë dhe në atë kohë kishte kontakte me shumë patriotë të vlerave të larta kombëtare. Në këtë rast, sipas kryetares të komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila, - Fadil Hoxha zë vend të rëndësishëm jo vetëm për Komunën e Gjakovës por për mbarë Kosovën, pasi që në kohën kur i shërbeu një ish sistemi, ai u angazhua që të vendosë themelet



themelimit e instituteve e fakulteteve për të përfunduar me themelet e Universitetit dhe Akademisë e Arteve dhe Shkencave të Kosovës. "Fadil Hoxha, po ashtu ia ka dalë me sukses të

tij, andaj duke u nisur nga ajo që u tha më lart, me plot bindje e përkrahje propozimin që Fadil Hoxha të dekorohet me dekoratën "Nderi i Kombit" me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij", shprehet ndër të tjera znj.Mimoza Kusari - Lila, në letrën drejtuar Presidentit të RSH, z.Bujar Nishani. Në të njetën linjë me kryetaren e Komunës së Gjakovës shprehen edhe Shoqata e Intelektualëve "JAKOVA", Gjakovë, si dhe tetë anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ndërkohë që shkrimtari i njohur Veton Surroji i është drejtuar posaçërisht kreut të shtetit shqiptar, Nishani, që të konsiderojë iniciativën që Fadil Hoxhës, në 100 - vjetorin e tij të lindjes, më 2016, t'i akordohet çmimi "Nderi i Kombit". Për kurorëzimin me suk-

ses të kësaj iniciative, para disa ditësh u takuan në Tiranë një përfaqësi e Shoqatës të veteranëve të LANÇ të Kosovës e përbërë nga kryetari, Zija Mulhaxha, akademiku Jusuf Bajraktari dhe Leka Hoxha (djali i Fadil Hoxhës) me kryetarin e OBVL, gjeneral - lejtënant Rrahman Parllaku - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, nënkryetarin Myfit Guxholli dhe sekretarin organizativ Sotir Budina. Në këtë takim, z.Parllaku foli për vlerat dhe meritat e Fadil Hoxhës, si gjatë Luftës NCCl dhe për ngritjen e konsolidimit e institucioneve kosovare gjatë kohës që Kosova ishte në kuadrin e Federatës Jugosllave. Nga ky takim u konkludua për një program të veçantë veprimtarish të përbashkëta në kuadrin e 100-vjetorit të lindjes së Fadil Hoxhës.

Kryesia e Shoqatës të Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe OBVL, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore të Gjakovës i kanë propozuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani që Fadil Hoxha të dekorohet me "NDERI I KOMBIT".

Në letrën drejtuar kreut të shtetit shqiptar, kryetarja e Komunës së Gjakovës, Znj.Mimoza Kusari - Lila, ndër të tjera shprehet se e mbështet fuqishëm këtë propozim, për faktin se "Fadil Hoxha, me kontributin dhe angazhimin e tij patriotik ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe pas çlirimit, ku si një burrë shtetas ka vendosur themelet e para të shtetësisë së Kosovës". Numri një i qytetit të Gjakovës, arsyeton gjithashtu se "Fadil



e para të shtetësisë së Kosovës. Ai pas çlirimit u vu në krye të Kosovës të cilën e trashëgoi me 97 përqind të popullatës analfabet. Gjithashtu kontribuoi në hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, në

paraqesë, të mbrojtje dhe të avancojë kauzën e shqiptarëve të Kosovës, por edhe të shqiptarëve jashtë Kosovës. Shembulli që politika mund të marrë nga veprimtaria e Fadil Hoxhës është largpamësia e

**HYRA KABASH MARGJEKAJ SHPREHET ME VARGJE POETIKE E NOTA EMOCIONALE**

## MALËSIA E GJAKOVËS GJITHMONË BAZË LUFTE E BUKE PËR LIRINË E KOSOVËS E TË MBARË ATDHEUT



Kisha dëgjuar se Hyra Ka bash Margjekaj prej fs hatit Shumicë të Gashit, e martuar në fshatin Bujan me Idriz Jahë Margjekaj, i cili ishte arsimtar i dalluar me shërbim në disa fshatra si: Zogaj, Valbonë, Qerem, Lekbibaj, Por ishte edhe interpretes i veglave muzikore, sidomos të fyellit, deri në atë nivel sa më 1960 merrë pjesë edhe në festivalin Folklorik Kombëtar, në Gjirokastrë, ku qe pritur me brohoritje.

Idrizi edhe pse i moshuar, vazhdoi në Elbasan 2 vjet shkollën e mesme pedagogjike. Më pas u caktua kujdestar konvikti në fshatin Valbonë,-1 vit, mësues në fshatin Qerem,-1 vit, Lekbibaj, 1 vit. Si mbaroi shërbimin ushtarak dy vjet në Tiranë për 3 vjet shërbeu inspektor arsimit në Tropojë. Duke ndërjer nevojën për studime të larta vazhdoi në Shkodër, më 1963-'64 Institutin e Lartë Pedagogjik. Hyra pati 6 fëmijë, tre djem e tri vajza me Idrizin dhe së bashku i rritën, i edukuan dhe i shkolluan: Sokolin në shkollën e policisë Tiranë, Zarifja mbaroi të mesmen ekonomike, Lezhë; Suzana është diplomuar për Bio-Kimi Shkodër, sot

emigrante familjarisht në Kanada; Selvana, këngëtare në Ansambllin "Dardania" emigrante në Zvicër, martuar me Gazmend Ferit Kabashin nga Prizreni dhe ai emigrant në Zvicër. Hysnia, djali tjetër i kësaj familjeje detyrohet të emigrojë në Spanjë. Edhe Agimi i vëllai e ndoqi për 3 vjet emigrant po në Spanjë, po nuk u shkëput dot prej Malësisë dhe iu kthye shtëpisë në fshat, Bujanin historik ku do të merrej kryesisht me bujqësi bashkë me nënë Hyrën e kunatën Mira Halil Margjekaj, e shoqja e Hynisë. Me 3-4 korrik 2014 më pritën aq bujarisht, kur shkova të plotësoja disa burime për një botim për traditat etnokulturale të organizimit tradicional të Malësisë në raport me Pukën. Hyra ishte në merak për gjyshin e hallë Rushën, për të cilët tregon: Rexhep Rexha postier i Bajram Currit. Espiunuan dhe serbët i qesin pritën në Babai të Bokës. Rusha; halla vritet në Babaj t'Boks e vdes aty. Gjyshin e morën prej Zogajsh e në Shkodër, në spital, ku arriti si i ishte infektuar plaga në qafë, se e prenë serbët. Gjetëm në Zogaj një këngë kushtuar atyre: "....RRUGA LARG E BORA

RANDË, /PREJ TROPOJE, N' SHKODËR N'KAMBË, / PEZEM PLAGA I PASKA MARRË, /S'PASKAN DOKTORAT ÇKA I BAJNË. / N' ITALI KANË THANË ME ÇUE, / POR REXHEP REXHA JETË PASKA NDRRUE. / PO MBAS VETI REXHA LA DJALË KABASHIN, /PO KY, KABASHI KREJT ÇBRATIN E LAU ME GJAK! / SE KY ISH KANË FATI I MALËSISË! /DERË PER DERË E SHPI PËR SHPI, /PËR KOSOVË E ATDHE GJITHMONË ME U SHKRI, /PER ME MBAJTË EMNIN SHQIPTARI!"

Kanga vue kur u vra gjyshi para 90 vjetësh. Kangën nuk e gjetën as babë Kabashi, nuk arriti t'i gjente dëshmitë për Rexhepin e Rushen. (Rusha martuar në Zogaj) mora dëshminë e jau çova atje. E kërkova edhe kangën. Edhe babë kabashi ndoqi shembullin e të atit, i cili u plagosë rëndë gjatë Luftës II Botërore. Prej asaj plage vdiq. Kur po luftonte me shokë për çlirimin e Gjakovës prej një minareje gjuhej me snajper. U vra: Rustem Avdyli i Bujanit, Ali Brahimi i Breçanit, mbi Markaj, plagosen: Isuf Cuja i Geghysenit e Kabash Rexhepin e Zenel Ahmetin të Mejdanit të Gashit. Hyra Kabash Rexha e nxitur edhe prej të shoqit, mësues Idrizit, nuk iu nda pasqyrimin të atdhetarizmit të shtëpisë së vet e rrethinë. Në kudrin e 100-vjetorit të Pavarësisë mblodhi copëzat e ngjarjeve dhe të këngës e si plotësoi këngën me vargje poetike i përhapi nëpër MALËSI, por i vinte keq që nuk u muar kush me vlerësimet e duhura prej pushtetit vendor dhe Qarkut të Kukësit. M'u lut t'i publikoja me ndonjë shkrim.

**Xhemal Meçi  
"Mjeshtër i madh"**

## Një rrugë në Gjilan pagëzohet me " Vëllëzrit Vesel dhe Vehbi Rexhepi" KRENARE DERI NË QIELL...!!!

Nga Drita REXHEPI

Një ndenjë dhe një njoftim jo i rastësishëm, me një person jo të rastësishëm, në një moment jo të rastësishëm. Filloj tema jo e rastësishme, për familjen time, për kontributin e babis Vebhi Rexhepi dhe axhës (vëllait të tij) Vesel Rexhepi. Jo vetëm për Gjilanin, por edhe për çështjen kombëtare...për faktin se baba ishte Kryetari i parë i Srezit të atëhershëm të Gjilanit (pas luftës së dytë botërore)... për faktin se të dy vuanin burgun famkeq, burgun e torturave të jashtëzakonshme, Goli Otokun, ose Alkatrazin siç e quanin. Gjithashtu, edhe për faktin se tërë kohën jetuan të përcjellur (survejuar), të përndjekur, të anatemuar, të stigmatizuar. Në vitin 1963 ishin të dytë në listë për likuidim, si "Nacionalistë të rrezikshëm shqiptar". Listën e kishte hartuar Aleksandar Rankoviçi. Gjatë bisedës potencova, se, e vërteta jonë e hidhur, rezistenca e tejskajshme dhe ende e pandriçuar e shumë in-

dividëve të anatemuar si Babi (Vehbi Rexhepi) e Axha (Vesel Rexhepi), e shumë veprimtarë të tjerë shqiptarë, janë detyrimi ynë më i madh, ndaj historisë dhe gjeneratave...janë konteksti më i qartë i luftës dhe i paqes, i shkaqeve, pasojave, rrethanave dhe faktorëve të tjerë që i paraprinë shtetit të sotëm sovran të Kosovës...pastaj, jo rastësishtë, lindi idea që një rrugë në Gjilan të pagëzohet me "Vëllëzrit Vesel dhe Vehbi Rexhepi"... Znj. Gjylshen Berisha, person të cilin e kam takuar jo rastësisht, sepse në jetë asgjë nuk është rastësishme, përveç që e kuptoj kontributin dhe sakrificën e tyre për kauzën kombëtare, e jetësoi dhe e realizoi idenë.

Tani një rrugë në Gjilan e mban emrin "Vëllëzrit Vesel dhe Vehbi Rexhepi"... Zonjës Gjylshen Berisha i falënderohem pafundësishtë...ja çka bënë fuqia e dy femrave...unë si vajzë e (Vehbi) dhe mbesa e (Vesel) Rexhepi, Znjë Gjylshen person i duhur në kohën e duhur, realizuam ëndërrën time jetësore...përkundër faktit se e vajtojshin babin tim që nuk ka djalë. Tri vajzat e tij jetojnë jashtë Kosovës. Unë jam e vetmja vajzë e Vehbi Rexhepit dhe bashkë me djalin tim mbeta të jetoj në Kosovë... Kushedi... ndoshta për ti dhënë pak dritë errësirës, ngushëllimit të tij, jetës së tij - ferr! Por sigurisht dhe për të përmbushur amanetin e të dyve...të Babës dhe të Nanës. Porosia e tyre ishte "MOS E BRAKTISË KOSOVËN...!!!!"





## LIBRI

Refleksione mbi librin "Rrënjët historike të Kastriotëve të Çidhnës"

## Dr. Islam Cani, kërkimtari i palodhur i rrënjës së Kastriotëve

Nga Namik Selmani  
shkrimtar

Akoma dhe sot nuk i kam të shlyera mbresat dhe emocionet që më dha leximi dhe studimi i librit të parë të botuar para dy vitesh i Dr. Islam Cani "Çidhna dje, sot dhe nesër". Një libër që lexohet me një frymë jo thjesht për intrigën, për dramën, për dhimbjen e dashurinë, por për atë motiv aq të fortë dhe për një dashuri për çdo gjë që kishte dhe ka autori për Çidhnën e tij. Për t'i lënë vendlindjes shumë më tepër se ç'mund t'i lërë një njeri i zakonshëm. Nuk është fjala vetëm për një krenari që e shohim gati dhe të artificialtë në mjediset tona shoqërore.

Kur lexoja dhe punoja më atë libër, mendja më shkonte te rrënjët njerëzore që janë sa të bukura, aq dhe të vështira e të mistershme dhe duhet të jesh fort këmbëngulës për t'i njohur e pastaj filizet e saj më të shëndetshëm t'i mbjellësh për kohërat që ti nuk do t'i jetosh, por do i jetojnë të tjerë. E dobia e këtyre librave është shumë më e madhe sa nuk matet kurrë me disa Mirënjohje që mund të të jepin një ditë mes dritash mes buzëqeshjeve të panumërta të shoqëruara me një gotë vere shampanje. Këtë sfidë njerëzore mentale e ka marrë përsipër dr. Islam Cani për ta bërë në këtë libër. Kodi i Kujtesës së shoqërisë njerëzore në këto libra i dërgon autorët që i bëjnë atone një hark vitesh shumë më jetëgjatë në kujtesë se ndërtesat e kalave, të hapjes së rrugëve, të ndërtimit të urave, të hapjes së burimeve në male, të ndërtimit të mullinjve për miellin e bukës së përditshme, etj."

Ishte Porta e parë e një cikli veprash që ai do na i japë njëra pas tjetër. Një lloj kontrate balzakiane do të thojë unë, me lexuesit jo vetëm të Dibrës, por dhe më gjërë, kudo ku flitet shqip e frymohet shqip e mendohet shqip. Një lloj garimi me Balzakun, një garim fisnik se ai nuk meritë me Parisin e madh e të zhurshëm, me Parisin e metrove dhe atë luvrian, me botët njerëzore të të gjithë shtresave, por me Çidhnën e tij. Duket se zoti i ka dhënë një jetë të gjatë dhe kaq prodhimtare në studimet e tij sa ta quajë të qetë veten në të gjithë brezat që do të vijin në këtë mision të madh nga më të bukurit.

Ishte libri i parë i një cikli që edhe mua, ndonëse nuk jam me rrënjë e degë dibrani, aq më shumë nga Çidhna, e ndjeva veten po kaq dibran e çidhnak sa dhe vetë autori. E libra të tillë të vijin rrallë në jetë. Madje dhe të bëjnë krenar me veten përtej asaj buravecërie krahinore që na ka përfshirë shumë herë me e pavend në tribuna, në ekrane, për të thënë kudo qoftë dhe me fjalën e shkruar se në x krahinë janë vlerat më të larta të kombit, etj e askund tjetër. etj.

Në profesion në të njëjtën kohë ai është edhe jurist, kimist e të gjitha këto njohuri shkencore, ai i ka përdorur si jo më mirë në librin e tij të parë. E mund të merrte lavdi të përjetshme shkronjore edhe vetëm me atë libër që pati shumë jehonë të madhe

në rrethet kulturore, shkencore, pse jo dhe patriotike. Se në të njëjtën kohë atë vepër madhore, ai e kishte ngjizur një jetë të tërë. I kishte dhe i ka të gjitha dobitë që mund të ketë një libër në këtë libromani që na ka përfshirë dhe në shqiptarëve të uritur shumë herë për ballina. Madje ai libër ishte ngjizur me breza të tërë më pare. Jo rastësisht librin ai ia kushton nënës së tij, asaj nëne që e ka edukuar jo vetëm me dashurinë për shkronjën shqipe dhe për shkronjat e të gjithë gjuhëve të botës, por së pari për me dëshirën për të lexuar. Për të kuptuar LIBRIN E KALAVE TË ÇIDHNËS, TË BURIMEVE, TË FJALËVE TË URITA, TË TOPONIMEVE. E të gjitha këto lidhen me vatrën çidhnake. Të atij fshati që me aq argumenta të pakundërshtueshme, mund të quash pa asnjë mëdyshje "Fshati i mbretërve", "Fshati i begatisë", "Fshati i bletëve", "Fshati i Burimeve". Unë do të shtoja sot duke mbyllur së lexuari dorëshkrimin e librit të tij më të ri dhe "fshati i filozofëve, i entografëve, i historianëve." Si mund të quash në 100 vitet e fundit dhe Gjyokastrën atje poshtë në Jug "Qyteti i kadilerëve (gjykatësve)" për nga numri i gjykatësve që ka nxjerrë në këtë shekull.

Libri që po marrin në duar lexuesët, ka një mision shumë fisnik: të tregojë historinë fisnore të Kastriotëve që ka lindur në këtë fshat të njohur të Dibrës dhe që, më tej ka ecur në botë e ka pushtuar "Perandorinë e Kujtesës Kombëtare."

Ka bërë që të flasim me një zë të fortë cicëronët shumëgjuhësh në të gjithë muzetë e botës që kanë, qoftë dhe një pavion për Gjergj Kastriotin Skënderbeun. Në traditën botërore të leximit të librave të tillë duhet që të kesh patjetër një laps në dorë. Një mënyrë të tillë leximi dhe studi-

mi doktor Islami, si i thënë shumë njerëz në bashkëbisedimin e përditshëm të tyre, e ka dhe vetë ai. Duke i shtuar dhe lupën që ai e përdor shpesh në mënyrë që të mos i ikë asnjë shenjë sado e vogël që mund të japë gjurmë pasaktësie në atë që lexon, që shënon, që nënvizon. Një laps për të veçuar argumentet. Një fakt që të rrjedhin në këtë libër aq natyrshëm. Emocionet që të jep fitimitari i një beteje të bukur, të madhe, të gjatë, në kohë e në vargan libror që më tej të bëhen "brumë" për këtë libër jete si mund ta quajmë atë.

Duke e parë në këtë kënd të veçantë, libri duket se është një betejë e fituar me të gjithë. Jo me atë brutalitetin e atij që flet me zë të lartë e jo me qetësinë e një të maturi, me qetësinë e atij që nuk ka nevojë që të jetë i tillë, të jetë Grafoman nëse do të përdorja një term klasik të nënjeriu që shkruan e nuk di se ç'shkruan.

Vetë motoja e librit të tij, ose motivi si thuhet profesionalisht në letërsi kur duam të themi shtysën e shkrimit dhe të botimit të librit është një thënie që ai e ka vënë që në hyrje të tij "Njeriu pa dijeni për të kaluarën, është si druri pa rrënjë" e më tej ai, duke gjetur simbolikën e Kastriotëve si fis dhe të jetës dhe bëmave të Skënderbeut, thotë se "Dashuria për atdheun është mbi gjithçka. Njerëzit njësohen me veprat e tyre dhe kurrë nuk harrohen."

O ju lexues të këtij libri, pasi ta keni shuar kureshtjen për ato që shkruhen mes sa sa e sa citimeve të marra nga libra, enciklopedive, fjalorëve dhe shumë pak nga gojëdhënat që gjithsesi janë Libri i hapur i së vërtetës kur mungonte shkronja e shkruar, vëreni një çast burimet që e ushqejnë të vërtetën e këtij libri!!!


O. unë nuk jam dorëzuar për të atë Gjyq të së Vërtetës që ka marrë përsipër që të tregojë autori që nganjëherë ka pak laookontizëm me veten!

Më duhet sot që të them një të vërtetë që e prekim të gjithë kur e marrim këtë libër në duar. Për të vërtetuar origjinën e Kastriotëve të Çidhnës si një kryekastriolog ai ka shfletuar fjalorë të panumërt vendas dhe të huaj, si ai latinsht-shqip, latinisht-anglisht, Fjalorin e Mitlogjisë, atë të Gjuhës së Sotme Shqipe, Fjalorin Shpjegues të Termave të Historisë, Fjalorin italisht-shqip, atë të Arkeologjisë, Fjalorin Enciklopedik. botimet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ka thirrur në ndihmë si "Komandant" i vërtetë të gjithë ata që kanë shkruar për Dibrën e për Çidhnën. Dhe nuk janë pak, autorë të huaj e shqiptarë. Është një listë e gjatë. Dhe, si për çudi, është maja e studiuesve shqiptarë që jetojnë ose nuk jetojnë. Në listën e studiuesve shqiptarë janë Kristo Frashëri, Eqerem Çabej, Naim Frashëri, Aristidh Kola, Marin Barleti, Aleksandër Xhuvani, Xhevat Lloshi, Shtjefën Gjeçovi, Dhimitër Pilika, Mateo Aref, Muharrem Abazi, Fatos Daci, Hysen Dërvishi, Ardit Miti, Eglantina Serjani, Luan Godo, Gjetë Ndoj, Jaho Brahaj, Skënder Anamali, Frano Prendi, Muzafer Korkuti, etj. Në listën e gjatë të studiuesve të huaj janë Enco Gati, Paolo Petta, Robert D'angely, Milan Shullaj, Nikos Stylos, Xhuzep Skiroi, etj. Një sy naiv, por edhe pak dashakeq, mund të shtrojë një pyetje kur shoh këtë listë të gjatë referuesësh që i përkasin vetem një fshati, madje vetëm një argumenti se disa të tilla që lidhen me Çidhnën ai i ka trajtuar më parë: "Çfarë i bashkon këta njerëz që i përkasin profesioneve të ndryshëm në studimet e tyre si: arkeologë, hartografë, gjeografë, gjuhëtarë, filozofë, historianë, poetë, kronikanë, gazetarë, etj?" E thjeshtë. Ai ka marrë të gjithë listë studi-

uesësh dhe i ka përdorur për të argumentuar këtë tezë duke e bërë garën me veten dhe të tjerët gati ta pakalueshme dhe plotësisht të fituar nga çdo studiues tjetër. Ose për të thënë se të duhet se tërë këta studiues shqiptarë e të huaj kanë shpenzuar kaq shumë kohë dhe që doktori i ka mbledhur dhe i ka vënë në radhë të gjykimit të tij shumë të qartë, të saktë.

E duke e parë në atë sfidë të palodhshmërisë këtë libër, do të thoja se ai ka brenda çdo fjale, argumenti në çdo rresht Motivin e Bletës. Bletologët e botës kanë thënë brenda tërë atyre të dhënave që mban jeta dhe aktivitetin e tyre një thënie paksa hyjnore dhe njerëzore që lidhet me punë e tyre ka të dobishme për njerëzit. E para është se bleta është njëra nga dy gjërat që zoti u ka dërguar njerëzve. I pari është besimi për ta pastruar shpirtërisht njeriun dhe e dyta është bleta që e shëron atë nga të gjithë sëmundjet trupore. E vetëm për të bërë një kilogram mjaltë, asaj i duhet që të shkojë në të paktën dy milion lule e të thithë nektarin e tyre.

Një nga pikat më të forta të këtij libri është pikërisht kjo punë madhe që ai ka bërë. Libri tashmë është pasuri kulturore jo vetëm e çidhnake dhe e studiuesve që janë marrë e do të merren me të, por edhe të mbarë kulturës sonë kombëtare, e kastriologëve që do të jenë të shumë më tepër në numër edhe më tutje në Shqipëri dhe në gjithë vendet e botës. Nuk është rastësi që mjaft burime dokumentare autori i ka marrë dhe nga burime studimore amerikane. E për këtë duhet falenderuar urtaku i përsëritshëm në pasionin e mbledhjes së të dhënave, dibrani, çidhnaku i përjetshëm që jeton me historinë dhe emocionet e këtij fshati kaq të mbarë, të çuditshëm dhe që është bërë të paktën në 500 vitet e fundit një lloj semafori historie për mbarë kombin tonë.





DOSSIER

# Skënderbeu, ndër 12 komandantët ushtarakë më brilantë të historisë

Në epokën e modernizuar dhe të mekanizuar të luftës, ku vendimet merren nga civilët, oficerët larg frontit të luftimit, komitetet kongresionale dhe strategët e panjohur ushtarakë, ushtria është diçka pa një fytyrë drejtuese dhe përgjegjësitë dhe ndahen mes shumë figurave. Dikur përgjegjësia dhe pasojat nuk ishin aq të ndara. Strategjia brilante, teknika dhe mendjet logjistike kishin kontroll total të ushtrive të mëdha dhe ato ushtri u bënë fitimtare ose u mundën për shkak të aftësive të një njeriu të vetëm. Komandantët ushtarakë në listë kanë qenë komandantë në fushë, me autonomi të padiskutueshme në betejat e tyre dhe jo gjeneralë që qëndronin në karriget e tyre larg luftës. Në këtë artikull të ekspertëve të HistoryExtra do të eksplorojmë gjenitë ushtarakë, një listë figurash të famshëm ushtarakë. Liderë botërorë që vijjnë vetëm një herë në jetë, dhe që lënë shenjë në historinë e civilizimit njerëzor.

**1- ALEKSANDRI I MADH**



Aleksandri i Madh qëndron më lart se Napoleon Bonaparti përse i përket pushtimeve të tij në një periudhë më të shpejtë kohore. I kurorëzuar mbret në moshën 20-vjeçare, pasi i ati i tij, Filipi, u vra, Aleksandri vendosi të pushtonte të gjithë botën e njohur. Aleksandri plotësoi dëshirën e të atit për të pushtuar Persinë në pak vite, duke rrëzuar Mbretin Dar. Duke mos qenë i kënaqur me kaq pak territor, Aleksandri marshoi drejt më shumë pushtimeve në zonat ku sot shtrihet Afganistani dhe Azia Qëndrore. Në përpjekje për t'i rënë rreth e qark botës në rrugë oqeanore, Aleksandri u përpoq të pushtonte Indinë, por u bind nga ushtarët e tij për t'u rikthyer në Babiloni kur vdiq dhe në moshën 32-vjeçare, pasi kishte pushtuar një pjesë të madhe të botës, i kishte vënë 20 qyteteve emrin e tij si dhe përhap qytetërim helen.

**2- NAPOLEON BONAPARTI**



Napoleoni cilësohet si gjenerali më i aftë deri më sot. Ai ka udhëhequr fushata brilante ushtarake, ka përdorur forcën e përqendruar në sulme në fushën e betejës, ka zhvilluar trupat e pavarura dhe të plota të ush-

trisë (një sistem i përdorur akoma sot), ka instaluar udhëheqës kukulla, ka rekrutuar trupa nga çdo komb që mposhte, duke bërë revolucion në mënyrën e të luftuarit. Në dekadën e parë të shekullit të 19-të ai i drejtoi ushtritë e Francës kundër çdo fuqie të madhe evropiane dhe arriti të dominonte Evropën kontinentale, nëpërmjet një sërë fitoresh historike të gjata, në betejat të tilla si ajo e Austerlitzit dhe Fridlandit.

**3- HANNIBAL BARKA**



Kundërshtari më i tmerrshëm që Roma ka hasur, u rrit me detyrën e mposhtjes së romakëve nga babi i tij, Hasdrubali. Hanibali i la mënjanë taktikat kartagjenase të superioritetit pasiv detar dhe marshoi me elefantë në alpet italiane. Hanibali e pushtoi perandorinë e fuqishme Romake nëpërmjet alpeve. Ai mundi romakët në një sërë betejash në Trebë dhe Traseminë. Asnjëherë nuk ka humbur personalisht në një betejë me romakët dhe e ka mbajtur ushtrinë e tij në Itali për më shumë se një dekadë pas Luftës së Dytë Kartagjenase. Ai konsiderohet një prej strategëve më të mëdhenj ushtarakë që kanë ekzistuar. Armiqtë e tij romakë, madje adoptuan disa prej taktikave të tij për përdorimin e tyre.

**4- SUN TZU**



taktikave ushtarake, të cilat akoma mësojnë dhe inspirojnë liderë edhe pas 2500 vitesh, bëni gjënë e duhur nëse lexoni veprën "Arti i Luftës" nga Sun Tzu. Emri i Sun Tzu tani është i famshëm falë atij libri. Vepra brilante e Sun Tzu e trajton luftën nga ana filozofike, duke i trajtuar ato në detaje. Libri flet për strategjinë e durimit si një nga elementët bazë për fitimin e një lufte. Libri sot është shumë popullor jo vetëm për ushtarakët, por edhe për diplomatët, trajnerët e futbollit apo CEO-t e kompanive të ndryshme. Ajo çka e bën atë një figurë interesante ushtarake është se zgjidhte gjithnjë një qasje sa më pak të përgjakshme. Sun Tzu preferonte t'i fitonte luftërat pa nisur ato akoma. Gjennale.

**5- GEORGY ZHUKOV**



Kjo figurë ushtarake njihet për fitoren e Europës gjatë Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse përpjekjet sovjetike për të shtypur pushtimin nazist ishin diçka kolektive siç janë të gjithë luftërat në përgjithësi, Zhukov shihet si personi që shkatërroi makinerinë naziste të luftës. Në atë kohë, Hitleri e kishte thyer paktin e tij me Stalinin më 22 qershor 1941, dhe Zhukov ishte tashmë një oficer i gradës së lartë. I ngarkuar nga Stalini për të mbrojtur Moskën dhe të largonte gjermanët. Ushtria e Kuqe nën komandën e Zhukov ndaloi avancimin e nazistëve gjermanë dhe i mposhti ata. Zhukov vazhdoi të fitonte disa betejat të mëdha kundër gjermanëve. Ushtria e Zhukov marshoi në drejtim të perëndimit deri sa arriti në kryeqytetin e Gjermanisë Naziste, Berlin në pranverën e vitit 1945.

**6- ERVIN ROMMEL**



Ervin Rommel konsiderohet si babai i luftës moderne me tanqe. I lindur në një familje aristokrate gjermane, Rommel pa betejën e parë gjatë luftës së parë botërore gjatë fushatave gjermane në Rumani dhe Italinë e Veriut. Me kalimin e kohës u rrit në gradë dhe u bë instruktor ushtarak në luftën me tanqe në Berlin. Kur Lufta e Dytë Botërore shpërtheu, Rommel u kërkua sërisht në detyrë duke i shërbyer Rajhut dhe duke ngritur më shumë prestigjin e vetes si ushtarak i zoti. Gjatë kohës kur Gjermania nisi pushtimin e Francës dhe të Vendeve të Ulëta, divizioni ushtarak i Rommel u njoh me nofken "Divizioni i Fantazmave", për mënyrën se si njësi e tij ushtarake depërtonte në territorin e armikut. Jeta e tij u ndërpre tragjikisht kur u zbuluan disa prova se kishte marrë pjesë në disa komplete për të vrarë Adolf Hitlerin.

**7- SALADINI**



Saladini ka qenë lideri ushtarak më i shquar në kohën e Kryqëzatave, duke penguar sh-

tetet mësymëse të kryqëzatave dhe pushtimet evropiane, me të njëjtën gjakftohtësi. I njohur për qetësinë dhe nacionalitetin e tij, mungesën e fanatizmit dhe respektin ndaj kundërshtarëve, ai arriti të pushtonte Sirinë, Egjiptin dhe pjesën më të madhe të Izraelit modern, në mënyrë krejt të qëndrueshme dhe pa shumë vështirësi. Ai respektohej gjerësisht nga thuatse gjithë rivalët e tij dhe ka pasur një miqësi në korrespondencë me Rikard Zemërluanin, duke i dërguar atij dhurata, kuaj e madje dhe mjekun e tij personal.

**7- JUL CEZARI**



Fushata ushtarake e Cezarit kundër galëve vazhdon të jetë në librat e shumë akademive ushtarake në botë. Jul Cezari mori kontroll absolut të Republikës Romake dhe ushtrive të saj dhe kreu për herë të parë pushtimin romak të Britanisë. Ekspeditat ushtarake të Cezarit në çdo terren dhe në të gjitha kushtet klimaterike i detyrohet disiplinës strikte të legionarëve të tij, admirimi dhe devocioni i të cilëve ndaj tij ishte shembull tipik i brillacës së tij taktike. Gjithashtu ai i manovronte trupat e tij me një shpejtësi legjendare, si dhe përdorimi i sistemit me shifra që përdorte për të komunikuar me gjeneralët e tij.

**8- ATILA**



Emri i tij ishte bërë sinonim i frikës dhe dhunës. Gjatë udhëheqjes së tij, ai ishte një prej armiqve më të frikshëm të perandorive lindore dhe perëndimore. Ai pushtoi Ballkanin dy herë dhe marshoi nëpërmjet Francës, deri në Orleans përpara se të mundej në betejën e Shalonit. Ai nuk sulmoi as Kostandinopojën dhe as Romën. Në pjesën më të madhe të Evropës perëndimore ai është mishërimi i mizorisë dhe grykësisë. Në kontrast, disa historianë e përshkruajnë atë si një mbret të madh dhe fisnik. Atila i zgjeroi kufijtë e perandorisë hune nga kufijtë e Francës së ditëve moderne e deri në stepat e Rusisë, duke mbledhur forcën masive të gjithë fiseve dhe kombeve të para historikisht si të egër provincialë.

**9- XHINGIS KHAN**

Xhingis Khan është një figurë historike që e bën Atilën e



lartpërmendur të duket i butë përse i përket brutalitetit dhe terrorit absolut që shkaktonte. I njohur si themeluesi i Perandorisë Mongole, Xhingis Khan krijoi ndoshta territorin më të madh që një Perandori kishte krijuar në të gjithë historinë. Pushtimet mongole shoqëroheshin me therje civilësh nëse qeveritë e tyre bënin rezistencë. Pavarësisht reputacionit që Çingis Han dhe ushtria mongole morën, ai ishte gjithashtu i rëndësishëm në zbatimin e tolerancën fetare brenda Perandorisë dhe zhvilloi sistemin e meritokracisë. Edhe pas vdekjes së Çingis Han, perandoria mongole u zgjerua edhe më tej.

**10-SKËNDERBEU**



Të mos përfshijë komandantin ushtarak të njohur si Skënderbeu në listë nuk do të ishte e drejtë. Arsyeja që ai bëhet pjesë e kësaj listë është fakti që pavarësisht sa armiq kishte, ai arriti të mbizotëronte dhe u pengesë e Perandorisë Osmane për të pushtuar Europën. I lindur me emrin Gjergj Kastrioti në mbretërinë e vogël të Shqipërisë, Skënderbeu u zu rob nga sulltani osman.

Duke u rritur në radhët e ushtrisë osmane ai u rrit edhe për t'u bërë një prej gjeneralëve më të mëdhenj duke fituar titullin "Skënderbe", që do të thotë Zoti Aleksandër, që e barazonte atë me heroizma e Aleksandrit të Madh. Por kjo nuk e pengoi të kthehej në vendin e tij, gjë që zemëroi Perandorinë Osmane, që dërgoi për 25 vjet me radhë dërgoi ushtri të stërmëdha për ta pushtuar Shqipërinë, por pa sukses. Me ushtritë e tij që nuk arrinin në më shumë se 20 mijë njerëz, Skënderbeu arrinte t'i bënte ballë ushtrive dhjetë herë më shumë trupave të armikut. Për mbrojtjen e Europës Perëndimore nga hordhitë osmane, Papa i dha titullin "Kampion i Krishtit" Skënderbeut.

**11- XHORXH UASHINGTON**

Uashington ishte lideri më i rëndësishëm dhe mbase më i suksesshmi i forcave revolucionare amerikane që kërkonin pavarësinë nga perandoria britanike. Edhe pse i asistuar nga shumë vartës (duke përfshirë



## HOMAZH

HOMAZH PËR VETERANIN E SHQUAR TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE

IDRIZ METI, QYTETAR NDERI  
IBASHKIVE PUKË DHE LEZHË

Nga Xhemal MEÇI\*

Idriz Meti (Pukë, 04.01.1925 - Elbasan, 21.11.2015) që në moshën 17-vjeçare përfshihet në LËVIZJEN ANFNÇL fillimisht në Rrethet e rinisë antinazi-fashiste Pukë. Në vazhdim përkrahës i çetës "Pukë-Mirditë", partizan në Brigadën VI dhe XXII, sekretar i këshillit nacionalçlirimtar të fshatit Qerret i Eper, Pukë.

Pas çlirimit: sekretar i rinisë për zonën e Iballes, sekretar i dytë i rinisë i rrethit Pukë, instruktor rinie në Qarkun e Shkodrës. Me përvijën e fituar për realizimin e detyrave dhe përballimin e vështirësive të mbasluftës, me përkushtim në punë, edhe pse në moshën 22-vjeçare, më 1947-1952, do të zgjidhet kryetar i komitetit ekzekutiv të kp të rrethit të Pukës, ku spikati për aftësi e zotësi drejtuese. Pati raste, kur për cmirë e rivalitetit karrier-

- **Arif Halili, ish-deputet e drejtues:** Idriz Meti ishte nga një familjemikpritëse, bujare, e besës dhe patriotike "
- **Gjon Gjonaj, kryetar i Bashkisë Pukë:** -Idriz Meti, "qytetar Nderi" i Pukës e i Lezhës, do të ketë të gjitha nderet me homazhet në Bashki, kurorë lulesh mbi varr dhe një kënd të veçantë në Muzeun Historik të Pukës.
- **Prof. Dr. Mark Vuj:** -Idriz Meti ka merita të veçanta në arsimin tonë kombëtar.
- **Prof. DR. Qazim Dushku:** - Idriz Meti është njëri nga më të mirët mësues, që? ka jetuar e punuar në Lezhë.
- **DR. Sulejman Sula:** Idriz Meti: - ishte një gur themeli i qytetit të Pukës.
- **DR. Marash Ndoka:** - po të kishim disa drejtorë të tillë si Mark Vujin e Idriz Metin e t'i vinim në krye të shkollave, atëherë gjendja e tyre do të ishte shumë më e mirë."

detyruar ushtarak dhe arriti të fitonte besimin e qytetarëve dhe drejtuesve epror për shërbime në detyra drejtuese me rëndësi. Mbas kryerjes së shërbimit

Lezhë, ku shërbeu për dhjetë vjet: shërbim (përgjegjës i seksionit të bujqësisë, drejtor në ndërmarrjen bujqësore, sekretar i komitetit ekzekutiv të kp të rrethit,

ku me originalitet përdor metoda bashkëkohore me rëndësi kombëtare me përsosjen e kriterëve të drejtimit pedagogjik të shkollës, me ngritjen dhe aftësimin pedagogjiko-shkencor të trupit mësimore- edukativ, me plotësimin e kushteve të mësimin dhe edukimit, me plotësimin e kushteve të konviktit, kushtet e çlodhjes e argëtimit kulturor të rinisë shkollë e cila arrinë kalueshmëri të lartë, duke u diplomuar 2321 specialistë të mesëm ekonomik-bujqësor për disa rrethet të vendit, që numërohet si një pasuri shërbesash kombëtare, një kontribut me atributete për historikun e arsimit bujqësor të Lezhës dhe për mbarë vendin tonë.

Me daljen në pension, iu dha ky vlerësim nga arsimit i rrethit të Lezhës: "I shquar si intelektual, drejtues i spikatur e vizionar, qytetar, me respekt për kolegët e punonjësit mbeten ti-



izmi i ngritën intriga e shpifje, që Idrizi i kujtonte me "letrën nga salla" ("Një letër nga salla"). Por me sinqeritetin e tij, durimin e pastërtinë e tij morale i përballoi të gjitha intrigat e kurthet, transferimet shërbimit e

ushtarak, më 1955, emërohet kryetar i komitetit ekzekutiv të kp të lokalitetit të Hajmelit, Zadrimë, ku shërbeu me përkushtim për tre vjet

Shkurt 1948, këshilli i Qarkut të Shkodrës e cakton në

ku shquhet si kudo e kurdo për zotësi, aftësi, arritje e suksese.

Për 15 vjet të tjera (1971-1986) kryen detyrën e drejtorit të shkollës së mesme ekonomike-bujqësore në Lezhë me pjesëmarrje rajonale nxënë-

pare themelore të tij".

Gjithmonë i dalluar: për durim e vullnet, thjeshtësi e mirëkuptim, optimist e nismëtar, bujari, sinqeritet e besnikëri, -mesazhe për brezat e rinj.

Studiues e krijues. Kujtimet e tij i pasqyrojnë me vërtetësi e talent në botimet: "Kur jepja mësim" (2005), "Dështimi" (2005) "Mes pukjanëve" (2006), "Rrugë të vështira" (2012).

Këshilli i bashkisë Pukë Duke u nisur nga virtytet e këtij pukas model me vendimin nr. 13, datë 12.07.2006 i jep titullin e lartë: "Qytetar Nderi" "Për aftësi të veçanta drejtuese dhe kontributin e pakursyer për zhvillimin e rrethit të Pukës, për punë efektive pedagogjike, publicistike dhe cilësitë e spikaturave në veprimtaritë e tij intelektuale dhe qytetare me vizion për të ardhmen". Po kështu edhe Bashkia Lezhë me Vendimin Nr.18. dt. 04.07.2014 e shpall "Qytetar Nderi i Lezhës" "Për kontribut të dhënë si drejtues i pushtetit lokal, veteran i Luftës dhe punonjës dhe drejtues në fushë të arsimit." Familjet pukas në Lezhë me 170 specialistë të lartë, i kanë dhënë titullin: "Dekani mirësie dhe integrimi".

Skënderbeu, ndër 12 komandantët  
ushtarakë më brilantë të historisë

(Vijon nga faqja 8)



dhe Benedict Arnold, mprehtësia ushtarake e të cilit u megjullua nga tradhtia e tij e famshme), Uashingtoni rezultoi të ishte forca bashkuuese e ushtrisë Kontinentale, duke e çuar atë në fitore në Trenton dhe Jorktaun, si dhe duke i mbajtur forcat e ndara në pjesë së bashku, në

dimrin e vështirë në luginën Forxh. Zgjedhja e tij president, dy herë, pa kundërshtime serioze duke sikur ishte më e pakta që amerikanët mund të bënin për liderin e tyre ushtarak.

## 12- XHORXH S. PATON

Figura më kontraktore e forcave aleate në Luftës II Botërore, Paton mund të mendonte se ai ishte rimishërimi i luftëtarëve të lashtë, duke mbaruar guximin dhe eksperiencën e tyre në betejat e tij.

Në Luftën II Botërore ai përdori sulmet rufe të gjermanëve kundër tyre, duke përdorur njëkohësisht manovrat e trupave të armatosura amerikane për nxjerrjen jashtë loje të

fronteve gjermane e duke fituar kështu pjesë të mëdha terreni në periudha të shkurtra kohore.

Incidentet famëkeqe, duke përfshirë ekzekutimin e masakrave nga trupat nën komandën e tij çuan në rënien e imazhit të Paton, por ai mbetet udhëheqësi i fitores së forcave aleate në Evropë.



Njëri prej tyre Pashk Alia , i frymëzuar prej jetës dhe veprës së tij botoi për te libri "LEGJENDA - IDRIZ METI", (Lezhë,2015).ku ndër të tjera e nënvizon Idrizin, si:njeriu që "simbolizon shembullin më të mirë,të njeriut të thjeshtë, punëtor,luftëtarit të mirë,, fqinjit e veteranit të mirë,bashkëshortit e prindit shembullor,, " prandaj që kur u sëmur dhe sa pa vdekur i kishte pranë të gjithë,familjarët e miqtë e shokët, të cilët e përcolën në arkivol për në Pukë. Iu bashkuan në Tiranë shokët e qerretasit e pikëlluar: dr. S. Sula,Muhammed Nezir, Rexhep Toska,Refki Demushi, Fadil Çoba, vëllezërit Arif e Musa Halili. Nga Lezha iu bashkuan shoqëruar: Dedë Marashi, Lekë e Zef Prendi, Ndre Ndreu, Filip Hasani, Selim Nimani si dhe Pashk Alia , Ali Guri,Fran Palushi etj.Në Pukë e prisnin qindra vetë, ndër ta shumë qerretas: Jaho, Isa e Mustafë Tafilaku, Ramazan Pema, Riza Toska e t.j. Kryetari i Bashkisë Pukë, z. Gjon Gjonaj kishte marrë masat që në Bashki t'i bëheshin Homazhet e NDERIT. N/Kryetari i Bashkisë Z. Astrit Kuçi në emër të tij ngushëlloi familjen dhe përshëndeti e falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në homazh. Në emër të Kryetarit të OBVL-ës së Shqipërisë gjeneral Rrahman Parllakut, "Hero i Popullit" e "Nderi i Kombit" përshëndeti Xh. Meçi, sekretar i OBVL Pukë. Varrimi me nderime iu bë në Qerret si e kishte lënë me amanet. U preh në Varrezat e Kryekatundit, nën Rrasen e Kacalunit, ku kryqëzoheshin udhë antike e mesjetare që në lashtësi, që vinin prej Shkodrës, Lezhës e Danjës për në Pukë e viset e saj. Gjithshtu prej asaj rrase shkëmbore, bashkë me moshatarë e tij e kishte soditur qindra herë gjithë horizontin aq të hapur, piktoresk e frymëzues përreth Qerretit.

Këto vitet e fundit ishte vendosur në Elbasan pranë të afërmëve të tij, ku ishte i kënaqur, por nuk u shkëput asnjëherë prej Lezhës dhe vendlindjes së tij, Qerretit të Madh, Pukë. Me vëllezërit: Demushin, Isanë, nipat: Aliun, Ramadanin,Ajetin dhe gjithë qerretasit e pukasit në tërësi me të cilët ruajti dashurinë dhe respektin. Sa herë takoheshim më fliste për botimet, që duhej të vazhdonim për Pukën.Më kërkonte ta përfundoja sa më shpejt botimin për "Lashtësinë Iliro-Arbërore në Koman-Qerret-Kçirë" e rrethinë. Edhe ai sado 95-vjeçar, kishte në dorë botimin e gjashtë, të cilin vdekja e pamëshirshme ia preu në mes e ia rrëmbeu nga duart.

\*Studiues i Muzeut Historik të Pukës "Mjeshtër i Madh"



DOSSIER

Ushtaraku që mbeti deri në fund i nderuar, i respektuar dhe i dashur për këdo që e njohu a punoi me të



Nga SHPENDI TOPOLLAJ

# ADEM META, NJERIU PËR TË CILIN MË MERR MALLI



Me vlerat e tij të larta njerëzore dhe intelektuale, Adem Meta ishte nga ata burra që aq sa nuk të besohet se është larguar nga kjo jetë, aq dhe sa herë e kujton, të merr malli për të.

Me një zgjuarsiri natyrore që ishte karakteristike e krahinës prej nga vinte dhe me një kulturë të kultivuar, ndoshta qysh në banga e shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej", ai mbeti deri në fund i nderuar, i respektuar dhe i dashur për këdo që e njohu a punoi me të.

Për hir të fatit që më ndoqi aso kohe, unë nuk isha afër tij; madje qemë skajmërisht larg njeri - tjetrit. Ai, në detyrën më të lartë si komisar Korpusi e Divizioni, dhe unë në detyrën më të ulët në një cep të humbur. Por çuditërisht, kjo nuk na pengoi aspak që ta kuptojmë dhe ta duam njeri - tjetrin qysh në takimin e parë. Natyra e njeriut mbart brenda saj shumë mistere. Ka diçka të pashpjegueshme në të, mundet edhe në formë instinktive që i afron ose i largon ata sapa shikimet e tyre ndeshen. Ademi e kishte të shkruar në atë fytyrën e bukur dashurinë për të tjerët. Në buzëqeshjen e tij që nuk ju nda kurrë, secili kuptonte lehtësisht mirësinë, thjeshtësinë, finikërinë dhe inteligjencien e tij.

Ushtria si kudo, e tillë ishte edhe te ne; me ekupe, kontrole, alarme, analiza etj. që jo gjithmonë linin ndonjë shije të mirë të efektivat. Kuptohet që kishte dhe nga ata eprorë që duke u marrë me vogëlsira apo duke pasur synime jo fort dashamirëse, për të mos thënë meskine, sillnin në repart një gjendje aspak të këndshme bezdie, sa në subkonshiençë apo dhe hapur, lusnim që të mos na vinin më. Kurse ditën që në repart dukej komisar Ademi edhe gurët sikur gëzonin. Ai ishte i mirëpritur për këdo, pasi me praninë e tij, me fjalët e tij, me sjelljen e tij, me sinjeritetin e tij, përhapte gaz e hare.

Me një takt pedagogjik plot finesë dhe aspak të shtirur, ai jo vetëm dinte të fitonte zemrat e vartësve, por edhe t'i mobilizonte dhe fuste në punë ata.

Dora e tij ishte e ngrohtë për supin e cilindro. Ai ishte pa paragjykime dhe nuk qederosej shumë për biografira a masa ndëshkimore që me ose pa të drejtë ishin marrë për ndonjë oficer. Për më tepër, këta të fundit i afronte më shumë, si për t'u thënë të tjerëve se në punë edhe gabojmë, por ne jemi shqiptarë, shokë e vëllezër.

Unë isha njeri nga këta. Babanë tim që kishte qenë një nga luftëtarët e orëve të para dhe më pas kuadër i lartë dhe rreptësisht i ndershëm e kishin goditur shumë ashpër si mik të Petrit Dumes dhe për pasojë edhe mbi mua nuk resh-tën breshëritë e mlllefeve plot ligësi, sipas muzikës absurde marciale të asaj kohe. Atdheun dhe ushtrinë i doja me gjithë forcat e shpirtit, dhe punoja me të gjitha mundësitë dhe energjitë e mia, por ngjarjet kishin marrë një kthesë të papritur që nuk dihej se ku do përfundoj. Kisha nevojë për mbështetje, po ku ta gjeja atë. Në krye të partisë nëpër një sira, kishin sjellë ca matufë nga klasa punëtore të cilët me injorancën e tyre, oficerët e kulturuar i quanin pa një pa dy, të sëmurë nga intelektualizmi. Kur i thashë Ademit se mua më shihnin si armik, ngaqë libri me kritika letrare i prof. Rexhep Qoses që kisha lexuar dhe ata e kish-

in shfrytëzuar si "casus belli", mbante në ballinë fjalën esse (fr. essay - sprovë) të cilën ata e merrnin për eses, u mundua të më qetsonte dhe shtoi se "Një i ditur ka thënë se injoranca gjithmonë është gati të habitet." Duke marrë shkas nga kjo, shtova: "Ashtu është, ndaj dhe dikush tjetër ka thënë se të gjithë mendojnë të ndryshojnë botën, por askush nuk mendon të ndryshojë veten." "Po, ashtu thosh Tolstoi? Po kujt ja thoshte?" - m'a priti dhe në vijim më dha një këshillë: "Ti lexon dhe e di sesi porosiste Mark Tëeini: "Kurrë mos debato me budallenjtë, ata të tërheqin në nivelin e tyre dhe të mundin me përvojën e tyre."

Mesa dija, edhe vetë atë, injorantët atje lart e mërznisnin me lloj - lloj intrigash.

Shihja se atij i dhimbsesha, por më tepër edhe bindesha se Ademi lexonte shumë. Ishte kjo dhe arsyeja që ai herë pas here më ngarkonte mua disa nga ato mësimet treguese kushtuar edukimit kulturor të efektivava. Sillte në repartin ku shërbeja punëtorët politikë dhe indirekt u thosh atyre: Ja, mësoni nga ky i përjashtuari nga Partia.

Dhe ndodhi njëherë që pasi panë se si e organizoja kulturën masive, ku atë mbasdite u diskutua me efektivin libri i Shaban Vanit "Kur dëgjojmë operën", dikush i kishte thënë Ademit se ky i dënuari kërkon të fusë operat në ushtri, ndaj mendoj se nuk bëre mirë që na çove tek ai. Dhe Ademi i qe kthyer i nevrikosur: "Po se mos e bën ti më mirë se ai kulturën masive dhe s'i prura kuadrot te ti. Edhe opera do dëgjojnë ushtarët se njerëz me ndjenja si gjithë të tjerët janë dhe kanë nevojë edhe për to. I lini këto budallëqe se keni mbetur në 45 - ën."

Pasi u bë riorganizimi i ushtrisë në funksion të atyre plenumëve famëkeqe dhe tani ishte komisar Divizioni, Ademi, kishte arritur të siguronte një aparat politik me njerëz të aftë, ku zëvendës të parë kishte njeriun e mirë dhe mikun e palodhur të librit Kujtim Pulajn. Kuadro të përzemërta dhe të arsyeshëm, ata ju bënë krah Ademit dhe kuptohej se ai ndihej shumë më i çlirët.

Rrinte - rrinte dhe vinte në repartin ku shërbeja në Karpen. Pinim ndonjë gotë raki a verë, se peshku atje nuk mungonte dhe bisedonim si shokë për artin, për kulturën, për librat e rinj që dilnin dhe hallet që ne mund të kishim. Me të e ndieje veten shok dhe i barabartë. Ai, asnjëherë nuk krijonte distancë me të tjerët. Gjatë pijes, si lab që ishte, edhe të ngacmonte, por gjithmonë me masë, se e dinte që ishim në repart. Kjo qe dhe përkrahja më e madhe që ai mund të më jepte, pasi kudo hapej fjala se atë e do, e vlerëson dhe e respekton vetë komisar i Divizionit.

Kur mësoi se ime shoqe kishte dhjetë vjet pa punë dhe se nipi i Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Durrësit Isa Kurti, kryente ushtrinë në repartin

tonë, më premtoi se do ndreqej dhe kjo gjë. Më tha se kur të të bëhet mbarë, më njofto dhe na prit për drekë në shtëpi. S'kaloi shumë dhe ashtu u bë. Unë, qoftë edhe për përkrahje morale kisha nevojë pas gjithë atyre masave që ishin marrë ndaj meje dhe tim eti. Se sot duket si pa rëndësi, por atëherë, të të vinin qoftë dhe për një vizitë, drejtues të këtyre rangjeve, kur ishe "i plevitosur" politikisht, nuk qe e kollajshme. Dhe këtë nuk e bënte kushdo, pasi gjithçka ishte e kontrolluar.

Kur një ditë ata erdhën, Ademi që e kishte paramenduar, i tha kryetarit të rrethit se gruaja e Shpendit është e pap-



unë dhe vetë ky e lë rrogën rrugëve, pasi prej një kohe të gjatë është shumë larg, atje ku djali i motrës tënde kryen ushtrinë. Kryetari që ishte dhe ai i prerë për të bërë mirë, na tha që të nesërmen të venim në zyrën e tij dhe gjithçka u rregullua.

S'kaloi shumë dhe mua më ngritën në përgjegjësi, duke më emëruar shef të shtabit të atij batalioni artmitralier. Nga që mungonte komandanti, batalionin e drejtoja unë. Në vitin 1986 u zhvillua një stërvitje e madhe ku do asistonte vetë Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë, Ramiz Alia. Ndërmjetës te ne kishte ardhur një instruktor i K.Q. që quhej Selim Fili, një burrë i qetë dhe me llogjikë. Ai, qëndroi disa ditë aty dhe kur pa angazhimin tim në stërvitje, por edhe rezultatat, i propozoi Komitetit të partisë që të më dekoronin. I kisha kushtuar jetën time ushtrisë, por dekoratë nuk kisha marrë ndonjëherë, ndaj m'u bë qejfi. Ademi e priti me kënaqësi propozimin, por diku ngeci. Kur stërvitja mbaroi me sukses dhe repartet do parakalonin para Ramiz Alisë, me marifet, batalionin tonë edhe pse ishte dalluar në këtë stërvitje, e shmangën, duke na thënë se do rrintim si dekor andej nga fundi. E kuptova se

dikush nuk donte që në krye të tij të parakaloja unë. Mbas dite, kur do bëhej analiza në Pallatin e Kulturës "Aleksandër Moisiu" në Durrës, mua, përsëri me marifet, më thanë se duhej të qëndroja në repart për efekt gatishmërie. Kjo qe një gënjeshtëri e madhe dhe fyese për mua, pasi atje shkua të gjithë.

Pas disa ditësh, takova Ademin dhe iu ankova për këtë qëndrim poshtërues që po mbahej ndaj meje. U mundua të më qetësonte duke qeshur dhe duke më rrahur shpatullat, dhe më la të kuptoja se kjo ishte punë e tjetër kujt, gjë që unë e dija. Shfrytëzova rastin dhe i tregova se instruktori i K.Q. Selim Fili më kishte siguruar se do bisedonte edhe njëherë në Komisionin Qendror të Kontrollit Revizionit për çështjen time dhe më priste në Tiranë. Ademi, më futi krahun dhe me zë të ulët më tha se mos prit ndonjë gjë, pasi L. H. nuk ka vetëm te ne. E kishte fjalën për një analfabet, ardhur nga terreni që mua s'më shihte dot me sy dhe vetë Ademin e kishte luftuar në shumë mënyra të pandershme. Dhe ashtu ishte vërtetë. O Zot! çfarë durimi duhej të kishe po të flisje me Pilo Peristerin, siç më kishte ndodhur mua dikur. Një nevrastenik dhe pa llogjikën elementare, ai të zhgënjente plotësisht. Më kishte kujtuar disa personazhe të pështirë nga ata që kisha lexuar. Dhe me këtë tip anëtar të K. Q. kishte punuar Adem Meta apo duhej të ndërhynte për mua Selimi. Ja përse asnjëherë nuk i vura faj Ademit, pse nuk më mbronte në atë Komision ku babanë tim e konsideronin puçist.

Por ai, përgatiti terrenin për të më

transferuar diku tjetër, afër shtëpisë. Mbi 15 vjet kisha qëndruar atje larg dhe vazhat po rriteshin. Kishin nevojë për praninë time. Ndaj, caktimi si komandant i batalionit të rinisë shkollorë në Golem, falë interesimit të Ademit te pasuesi i tij Gëzim Bega, për mua qe i domosdoshëm.

Edhe kur vetë atë e sollën në Durrës si komisar të Brigadës, ne e ruajtëm miqësinë. Pastaj, erdhën ngjarjet që njihen dhe unë u emërova shef i sektorit të Mbrojtjes Civile të Rrethit. Ishte koha e demokracisë, por gabimet vijonin dhe padrejtësisht, për të mos thënë edhe poshtërsisht, Ademin e sulmuan ashpër. Ai, ishte në pozitë delikate dhe tani kishte nevojë për përkrahje morale. Shokët e tij, i qëndruan gjithmonë pranë se e dinin se kush qe Adem Meta dhe çfarë karakteri burrëror kishte ai. Edhe unë e ndieja se duhej t'i shprehja solidaritetin e përkrahje shokut dhe eprorit tim që nuk e kishte fshehur simpatinë dhe përkrahjen e tij ndaj meje, kur ishte pak vështirë për të mos thënë e rrezikshme, për ta bërë këtë. Ndaj, sa herë takoheshim në rrugë, i fusja unë krahun dhe së bashku shkonim në zyrën time. Ai,

(Vijon ne faqen 11)



## PROFIL

*Çlirimi i vendit e gjeti Vilin në ballë të luftës së një brezi idealistësh për të shërruar plagët e luftës*

# Vili Mazreku, nipi i Luigj Gurakuqit, mjeku që i dha Elbasanit zemrën e tij në dorë

GËZIM LOKA

Në qytetin e lashtë të kulturës dhe bukurive të dyzuara, në qytetin e bashkëjetesës dhe harmonisë, ku shkëlqejnë familjet e mëdha me sharm atdhetar e kontribute në histori, në Shkodrën loke ka hedhur rrënjë e ka ardhur gjer në ditët tona një familje historike, familja e shquar Mazreku, me gjurmë në kohë dhe sot në aktualitetin shqiptar.

Kush shkel në qytetin e Shkodrës, qoftë dhe si vizitor i zakonshëm, nuk mund të mos kontaktojë me gjurmët e kësaj dere, që me kohë ka krijuar një portret të denjë për nder e respekt jo vetëm në këtë qytet perlë e antik, por dhe më gjërë.

Kjo familje është pjesë e palcës historike të Shkodrës, pjesë e identitetit historik të qytetit të mirënjohur.

Njëri nga pinjollët e kësaj dere fisnike është edhe Vili Mazreku, nipi historik i Luigj Gurakuqit, njërit nga luftëtarët dhe ideatorët e revolucionit Nolian, i cili qëndroi përkrah liderit iluzionist e pacifist, deri sa dha jetën për kombin e tij.

Vili Mazreku është vëllai i komentatorit brilant të sportit Anton Mazreku, i cili la një emër të ndritur në analet e gazetarisë dhe sportit shqiptar, me shkëlqimin e një ylli të papërsëritshëm me në valët e radiove dhe studio e televizioneve, ku gjëmoi fjalë e tij që dehu e mrekulloi mijëra e mijëra spektatorë.

Karriera e Vili Mazrekut nisi që në vitet e mbretërimit të mbretit Zog, i cili personalisht i dha një bursë studimi atij për të studiuar në fakultetin e Shkencave Mjekësore, në Bolonjë, në një nga shkollat e larta më të mira në këtë fushë në perëndim e më gjërë. Atje, në Bolonjë, ai dhe bashkëstudentet e tij përjetu-

an pushtimin e vendit, të cilin e pritën me indinjatë dhe revolta të forta, ndonëse jetonin e mësonin në vendin ku fashizmi kishte veshur së pari këmbëshën e tij të zezë dhe kishte shfaqur fytyrën e tij agresive në Europë e në mbarë botën.

Çlirimi i vendit e gjeti Vilin në ballë të luftës së një brezi idealistësh për të shërruar plagët e luftës, për të lënë prapa të kaaluarën konfliktuale në emër të një jete të re. Ai u emërua shef i mjeksisë së ushtrisë shqiptare dhe mori pjesë në provokacionet greke të gushtit 1949 ndaj trojeve shqiptare, ku u dallua për kurajo e trimëri dhe u dekorua nga institucionet e kohës. Por një martesë e beftë, me mbesën e patriotit të madh Aqif Pashë Elbasanit, ku implikohej dhe figura e Ibrahim Biçakut, ish kryeministër në kohën e nazi-fashizmit, do të bënte që djaloshin ta flaknin nga detyra dhe për pak të ende një kërkim të vetvetes. Atij i ra ylli i dashurisë me Shpresën, një vajzë e bukur nga Elbasani, të cilën rinia e kohës e quanin "bejleresha", ngaqë vinte nga një derë e kamur dhe dihet se në atë kohë lufta kundër njerëzve të kamur ishte ideologji vepruese e kohës.

Kjo martesë e zhvendosi një pjesë të derës së Mazrekëve të Shkodrës, një pinjoll të kësaj dere, në Elbasan, ku në hyrje të kësaj lagjeje të njohur, ngrihet madhështore një ndërtesë, që nderohet dhe respektohet prej të gjithëve e kjo është shtëpia e Pashës, shtëpia e Aqif Pashë Elbasanit, këtij atdhetari të kulluar e burri mendjendritur të historisë, kryetar i Kongresit të Lushnjës, i nderuar për kontributet e tij, si firmëtar i aktit të Pavarësisë dhe lirisë. Këtu, në shtrirjen e degëzimit e kësaj dere, bashkëngjiti martesën dhe ëndrrën e tij të re për jetën, intelektualin dhe mjeku Vili Mazreku. Që nga kjo kohë, kur ndodhi

kjo martesë fatlume, nuk mund të kuptohet familja e shquar e Mazrekëve të Shkodrës pa lidhjen e njohur e të farkëtuar në kohë të vështira për shqiptarinë me familjen e Pashës së ndritur të Elbasanit dhe pasardhësve të tij. Bashkimi i këtyre dy familjeve, njëra katolike, tjetra myslimane, njëra nga Veriu, tjetra nga Shqipëria e Mesme, njëra e lidhur me krahun e majtë liberal-demokratik të kohës, tjetra me krahun e djathtë radikal, por që në thelb të dyja i bashkonte dashuria e çiftit të porsalidhur dhe dashuria për tokën e tyre, për njerëzit dhe historinë e këtij vendi me gjurmë të ndritura në kohë...

E kështu, ajo vajzë e re, e mirënjohur në qytet si mbesa bukuroshe e Pashës, u dha fund shëtitjeve anës Kalasë së famshme të Skampës, e vetëdijshme se me atë lidhje, me atë martesë, po i bënte një shërbesë, po jepte një mesazh për dje, për sot dhe për nesër, se "Shqipëria", siç shprehej në gjallje Babagjyshi plak, është një e një do të jetë, jug e veri, lindje e perëndim, se ajo vajzë e thjeshtë, bijë e një dere të madhe, që mbante ndër deje gjakun e Pashës, por edhe në zemër, mbushur plot jetë e fuqi nga vepra e babës së saj, delegatit të Lushnjës, intelektualit të viteve 20' e më këtej, patriotit të madh, Beqir Rusi, tashmë nuse në Shkodrën loce, tek Mazrekët, do të justifikonte rrënjët dhe do t'i rriste lart e më lart ato.

Çifti i ri, siç thamë, u vendos në Elbasan dhe aty hodhi rrënjë. Pas një ecejake në detyra të ndryshme, në rrethe të ndryshme të vendit, Vilin e caktojnë mjek epidemiolog në Elbasan, ku për pak kohë do të bëhej shef i Epidemiologjisë në spitalin e rrethit të Elbasanit. Këtu do të punonte me përkushtim për njëzet e pesë vjet, duke iu shërbyer elbasansve ditën e natën, orar e pa orar, me një dashuri të madhe për njerëzit e këtij qyteti që u bë për të një qytet po aq i dashur sa Shkodra e tij.

Në shtëpinë e tyre të re, flitej për Shqipëri, për atdhe, për flamur, flitej për jetën, vinin njerëz nga ana e anës për t'u mjekuar dhe shpesh, ngaqë ishin larg e nuk ia dilnin të shkonin në shtëpinë e tyre, flinin tek shtëpia e çiftit të ri, që po bëhej për elbasanasit në nevojë një strehë mikpritëse e hall-zgjidhëse.

Puna ditë e natë, orar e pa orar, me përkushtimin e një misionari, nuk e lodhi Vilin kurrë dhe këtë edukatë, edukatën e punës, dashurinë për njerëzit dhe gadishmërinë për t'iu shërbyer të tjerave, ai ua edukoi dy fëmijëve, Serxhos dhe Inës, që do të behëshin quadro të aftë e me vizion për kohën dhe bashkëkohësit.

Siç duket, tradita, kultura e të dy familjeve prej nga burojnë këta pinjollë, dashuria për kulturën dhe shkencën, pasioni për të kontribuar për shoqërinë, janë gene që kulmojnë në një, në shpirtin e tyre atdhetar, në predispozitat e tyre sociale e humane, për të bërë diçka më shumë se realizimi i një ekzistence të zakonshme.

Pra, është ky detyrim atdhetar, ku pasionet dhe kontributet politike për kombin kanë qenë dhe mbeten pjesë e kredos së familjes Mazreku, që e shtyu Vilin, mjekun e shkëlqyer nga Shkodra, të ishte për çdo çast i motivuar në shërbimet e pa kufi për banorët në nevojë të Elbasanit.

"Vili Mazreku, thotë Flamur Harri, pinjoll i një familje të persekutuar nga Diktatura, ka qenë një mjek model, që nuk do të harrohet kurrë në qytetin e Elbasanit. Ai ishte jo vetëm i talentuar dhe plot pasion në fushën e tij, jo vetëm i papërtuar dhe human, por dhe me një shpirt



Foto: Vili Mazreku

të madh, ku rrezatonte mirësi, bujaria dhe vlerat e mirëfillëta qytetare e njerëzore. Intelektualë të tillë duhet të merren si modele edhe sot, pasi pa përkushtim dhe dashuri nuk mund të bëhet asgjë e denjë dhe serioze në këtë vend, që ka aq shumë nevojë për heronj dhe modele".

Në fillim të viteve '80, unë kam punuar si oficer në Elbasan dhe më ka rënë rasti ta takoj personalisht e të marrë kurime nga mjeku i nderuar, Vili Mazreku, kam parë e ndjekur përkushtimin e tij për punën, dashurinë për profesionin, thjeshtësinë dhe çiltërsinë e natyrshme, gadishmërinë e tij për të qenë gjithmonë gati, në çdo kohë, në shërbim të atyre që kishin nevojë për mjekimin e tij, por dhe për fjalën e ngrohtë e të pastër, që nuk i reshti kurrë në buzë.

Nuk do ta harroj kurrë atë buzëqeshjen e tij të çiltër, që tregonte modesti e mirësi, korrektesë e ndershmëri profesionale e njerëzore, mënyrën se si ky person depërtonte në zemrën dhe shpirtin e pacientëve dhe bashkëqytetarëve të tij.

Edhe pse kanë kaluar vite që Vili Mazreku nuk është më, emri i tij vazhdon të rrojë e të frymëzojë jo vetëm banorët e Kalasë, që e kishin bashkëqytetar dhe mik të të familjeve të tyre, por gjithë Elbasanin, gjithë ata që jo vetëm e kanë njohur dhe kanë përfituar nga shërbimet e tij, por dhe ata që kanë dëgjuar për të, kanë ndjekur gjurmët e punës së tij përkushtimtare në kohë.

Sa ishte gjallë, megjithë kulturën dhe dijet që zotëronte, institucionet e kohës së monizmit, për shkak të "njollave në biografi", nuk ia dhanë titullin "profesor". Titullin "profesor" ia dhanë njerëzit e thjeshtë, populli i Elbasanit, që e deshi dhe për të cilin atij i rrahu zemra gjer në fund të jetës.

Për kontributin e tij të shquar si mjek dhe intelektual ai është dekoruar dhe i janë dhënë tituj e grada respekti jo vetëm në kohën e komunizmit, por edhe në kohën e demokracisë, për të cilin kontribuoi aq shumë ky njeri progresist dhe idealist. Për merita të veçanta e kontribut në fushën e mjekësisë shqiptare, mjeku i nderuar Vili Mazreku është nderuar me dekoratë nga ish presidenti Sali Berisha.

Sot kur mjekët më shumë se drejt nevojave të pacientëve, rendin drejt interesave të tyre personale, drejt interesit të "xhepit", imazhi i një mjeku të një modeli tjetër, si ai i Vili Mazrekut, është një ftesë për reflektim, pasi tani më shumë se kurrë shoqëria shqiptare ka nevojë për njerëz idealistë, që të ngihen përmbi unin e tyre të ngushtë, përmbi interesat e tyre të vogla, në emër të një sistemi vlerash tek të cilat besonte Vili Mazreku dhe bashkëidealistët e tij.

## ADEM META, NJERIU PËR TË CILIN MË MERR MALLI

(Vijon nga faqja 10)

me shaka më thosh : "Mos po të prish biografinë?!" "Aq sa ta prishja edhe unë ty atëherë. Ti më nderon mor komisar" - qeshja dhe unë. Pastaj debatonim, siç qe në modë ato ditë. Unë, më i ashpër me kritikën ndaj sistemit që iku, ai më i butë. Por, me të kishe qejf të polemizojë, pasi ishte tolerant dhe të dëgjonte me vëmendje. Dhe asnjëherë nuk të zemërohej.

Një ditë më pohoi se "Nuk më shkon mua të zë e të shaj. Do dukesh pa dinjitet dhe do isha i pabesueshëm. U bë një ekperiment (se si çdo gjë që nuk është e përsosur edhe politika, edhe sistemet, eksperimente janë) dhe e çoi Shqipërinë deri në një farë vendi. Vjen tjetri, mëson nga gabimet e të parit dhe e shpie më tutje. Këtë duam të gjithë."

Më pas, unë fillova të shkruaj dhe të botoj libra në gjini të ndryshme. Ja jepja Adem dhe ai i lexonte me kënaqësi. Kishte momente që nuk qe në një mendje me ndonjë gjë nga ato që kisha shkruar unë dhe më bënte ndonjë vrejte. Pastaj, më përgëzonte me gjithë zemër, duke shtuar: "Ndaj dhe të kam dashur gjithmonë, se e dija që do bëheshe shkrimtar me emër." Qeshnim të dy.

Vitet e fundit, gjendja e tij shëndetësore filloi të rëndojë. Tani lëvizjet, Ademi plot dëshirë për jetën, i kishte të kufizuara. Mëngjesëve, i shoqëruar nga gruaja e tij e mrekullueshme Tixhja të cilën ai gjithmonë e përmendte me dashuri, zbriste shkallët dhe shkonin të kafeneja aty pranë, ku mua, përditë më

takonte të kaloja në të njëjtën orë, ngaqë më binte rruga për të shkuar në punë. Atij i qeshnin sytë kur më shihte dhe ca më shumë, kur uleshja dhe e pija kafënë me ta. Në tavolinën e tyre do gjeja përherë mikun tonë besnik, piktorin e talentuar Çausht Vathi nga Kavaja i cili kishte ardhur në Durrës me shtëpi. Edhe miqësia e Ademit me këtë njeri të thjeshtë është një shembull shumë domethënës i karakterit të tij të rrallë dhe i dashurisë së painteres që ai kishte për njerëzit. Ishte njohur me Çaushtin qysh kur atë dhe mua na kishin ngarkuar të bënim muzeun e Brigadës së Kavajës. Çaushti, duarflori dhe plot fantazi, punonte pa u kursyer dhe Ademi sa herë vinte, mbehte shumë i kënaqur nga puna e tij dhe ja shprehte admirimin. Muzeu, pas ndihmës së pakursyerer në materiale që na jepte një drejtor baze në Durrës i quajtur Habib Milaqi, doli shumë i bukur dhe u bë shembull në gjithë njësitë, kurse Ademi fitoi një mik, me të cilin nuk u nda më. I thosha Çaushtit se ti, duke nderuar Ademin, na bën nder të gjithë ne shokëve të tij që e duam aq shumë, por nuk na lë puna të rrimë sa duhet me të.

Tani, sa herë kaloj pranë asj kafeneje, instinktivisht kthej kokën se mos ndesh atë buzëqeshjen e ëmbël të një njeriu që e desha aq shumë. Por tavolina ku ai pinte kafënë e mëngjesit, tani është bosh. Ndjej një trishtim në shpirt, por dhe krenari, se në ditë të vështira, pata mik një njeri të rrallë si i paharruari Adem Meta, për të cilin më merr aq shumë malli...



**SPECIALE**

# Fjalimi origjinal i Ismail Qemalit më 28 Nëntor 1912!

**Nga Ismail Qemali\***

Oh! Sa të lumtur që e ndiej vehten sot, që shoh, këtu në Vlorë, kaqë burra Shqipëtarë të mbledhur tok, tuke pritur me kureshti e padurim përfundimin e kësaj mbledhjeje historike, për fatin e Atdheut tonë të dashur. Plot me gaz e me lot ndër sy, nga mallëngjimi, pra, po dal këtu para jush që t'ju gëzoj me sihariqin e madh, se sot, edhe këtë minutë, Kongresi çpalli mëvehtësinë e Shqipërisë, tuke lajmëruar gjithë botën mbarë për këtë punë e duke më ngarkuar mua kryesin' e qeveris së përkohshme të Shqipërisë së lirë.

Porsi ëndër më duket ky ndryshim i madh i vendit t'onë, që hoqi e voi të zezat e të lirit pesëqind vjet me radhë ndënë sundimin turk, por që tani në kohët e fundit, ishte gati të jepte shpirtin përgjithënjë, të

shuhej e të çfarrosej krejtësisht nga faqia e dheut, këjo Shqipëri, që, dikur, shkëlqente nga trimërija e pashoqe e bijve të saj; kjo Shqipëri, që kur i kërcënohej rreziku Europës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t'egër që ka pas Turqija. Mirëpo, desh Zoti, që me punën, me trimërinë dhe guximin e pashoqe të Shqipëtarëve, sot e tutje të marrin fund mjerimet dhe vuajtjet e Atdheut t'onë, sepse, këtu e kështu, jemi të LIRË të PAVARUR dhe MËVEHTE, prandaj: qeshni e gëzoni! Për t'ia arrijtur kësaj dite të bardhë e të madhe, na ka ndihmuar gjaku i dëshmorëve dhe puna e vlefshme e patriotëve t'anë dhe e të gjithë shokëve që muarrnë pjesë në këtë mbledhje dhe e të gjithë juve, që tani po ju gu-

fon zemëra nga gazi i madh që ndieni; mirëpo mbledhja si më plak që jam, m'a ngarkoi mua Ngritjen e shënjtë të shënjës t'onë Kombëtare, të flamurit t'onë të ëndërruar e të dashur (nxjerr Flamurin, të cilin e ka të vendosur në një shtizë hekuri, natyrisht të vogël, dhe të pshehur nën pallto dhe passi e mba një sekondë në dorë e ngul në shtyllat e ballkonit. Amatorët, posa e shohin Flamurin thërrasin me gëzim e me zë të lartë: Rroftë Flamuri, Rroftë Shqipërija e Lirë).

Ja, pra, ky është Flamuri Ynë i kuq e me shqiponjën dykrenare të zezë në mest. Dhe tani, të gjithë bashkë, si një trup i tërë dhe i pandarë, le të punojmë për t'a mburuar, për t'a përparuar e për t'a qytetëruar si i ka hije Atdhenë t'onë të Lirë.

Tuke përfunduar, s'më mbetet gjë, veçse t'i drejtoj një lutje Zotit të Madh, që, bashkë



me bekimet e Tij që i lipij të na japë për të qenë të denjë të kësaj dite, të pranojë që këtej e tutje të jem unë dëshmori më i parë i Atdheut, ashtu siç pata nderin dhe fatin që të jem i pari ta puth e ta bëj të valvitet i Lirë. Flamuri i ynë,

n'atdhenë t'onë të lirë.  
**Rroftë Flamuri!  
Rroftë Shqipërija!**

*"Fjalimi i Ismail Qemalit i mbajtur me 28 Nëntor 1912 në Mitingun e Madh në Vlorë me rastin e ngritjes së flamurit"*

## Dita e Pavarësisë festohet edhe në Melburn të Australisë



**Ambasadori i Kosovës në Australi, Sabri Kicmari në rrjetin e tij social në Facebook, ka postuar disa foto ku shihen flamujt kuq e zi të ngritur në kryeqytetin e Australisë, Melburn.**

Ai së bashku me një grup njerëzish po festojnë 103-vjetorin e Pavarësisë.

Në mëngjes të ditës së sotme, 28 Nëntor 2015, së bashku me udhëheqjen dhe shumë anëtarë të Komunitetit Shqiptar, nga të gjitha viset shqiptare, e ngritëm flamurin tonë kombëtar në Sheshin Kryesor të Melbournit - Federation Square. Ai do të valojë gjatë gjithë ditës së sotme për nder të historisë, kulturës dhe identitetit tonë kombëtar. Mijëra australianë do të kalojnë pranë flamurit tonë. Miqësia e popullit shqiptar me popullin e Australisë i ka rrënjët në vlerat e përbashkëta që përfaqësojnë popujt tanë. Gëzuar Dita e Flamurit gjithë shqiptarëve kudo ku jetojnë! shkruan ambasadori.

